

BIBLIOTEKA

8SH-32

K 14

ISMAIL KADARE



IKJA E SHTERGUT

Onufri

IKJA E SHTËRGUT

BIBLIOTEKA E
BASËKIS QIRIAKASTER
NR INV

56426

4 22.2.2
K 14

ISMAIL KADARE

IKJA E SHTËRGUT

BIBLIOTEKA E
SHKËMBI MIROKASTEB
NR. 137

Onufri

HJRJE

Në vitet 1987-1988 Ismail Kadare ka depozituar në Paris (Banque de la Cité 12, kasaforta nr. 1, Avenue Matignon) afër Champs-Élysées, disa krijime që, për shkak të kundërtotalitarizmit të hapur, përbënin rrezik të madh për të. Këto krijime ishin: romani *Hija*; romani *Vajza e Agamemnonit*, i shkruar në formë të dendësuar, rreth 100 faqe, motërzimi përfundimar i të cilit ende nuk është kryer; tregimet *Ikja e shtërgut* dhe *Vdekja e gruas ruse* si dhe disa poezi e letra.

Ismail Kadare ia dha çelësin, bashkë me autorizimin, presidentit të Fayard-it, Claude Durand, për ta hapur kasafortën në çdo rast që do ta quante të nevojshme, kuptohet, nëse shkrimtari do të ndodhej në rrezik. Claude Durand, që ishte në dijeni të plotë të përmbajtjes së tyre, në një rast të tillë, kishte të drejtë të bënte deklaratën përkatëse, t'i përthente dhe t'i botonte ato.

Ikja e shtërgut është i pari nga këto krijime që botohet në shqip. Ai është botuar më parë në frëngjisht, me titullin *Kërcënimi i diellit*, në gazetën *Le Monde*, Paris, korrik 1998.

PËRKRYERJA ARTISTIKE E NJË VEPRE BËN PJESË NË LIRINË E SAJ*

Bisedë e ISMAIL KADARESE me studiuesin BASHKIM KUÇUKU

[BASHIM KUÇUKU] *Në një bisedë jeni shprehur se ka një ndryshim të madh midis një vepre që e ke shkruar për ta botuar dhe asaj që e ke shkruar për të mos e botuar. Madje, keni thënë: Është një çudi e madhe kur një vepër e mbyll për të mos e botuar dhe pastaj e rimerr në dorë për ta parë. Cili është ndryshimi? Cila është çudia?*

[ISMAIL KADARE] Ky është një zbulim që shkrimtarëve iu qëllon ta bëjnë rrallë herë. Arsyet kryesore përse shkrimtarët kanë ndryrë veprat e tyre, për t'u botuar më pas, kanë qenë dy: vetjake ose politike. Kjo e fundit ka qenë, natyrisht, më dramatikja. Çudia, për të cilën kam folur dikur, ka lidhje me pyetjen se cila vepër është më e lirë, ajo që është shkruar për t'u mbajtur e fshehtë apo ajo tjetra, ajo e hedhura në botim. Në këtë rast, mendimi i parë që të vjen është se vepra më e lirë duhet të jetë ajo,

* Me dëshirën për të zbuluar në thellësi vetëdijen që përftoi tregimin *Ikja e shtërgut*, i drejtuam disa pyetje, shumë të nderuarit, Ismail Kadare, i cili pati mirësinë t'u përgjigjej.

e fshehura, e ndryra në sirtar. Zbulimi im, rrjedhimisht habia ime, ka qenë kur kam vënë re të kundërtën.

[B.K.] *Ju lutem, a mund ta shtjelloni këtë mendim më gjerësisht?*

[I.K.] Me sa duket, jeta dhe fytyra natyrale e një vepre sigurohet kur vepra krijohet për t'u botuar. Është natyrale kjo gjë edhe kur kushtet e botës, në të cilën vepra do të dalë, janë të ftohta e armiqësore me të. Me fjalë të tjera, e natyrshme është që vepra të dalë nga një terr, që është ndërgjegjja e shkrimtarit, jo për të hyrë në një terr tjetër, në një sirtar, në një kasafortë, si në sarkofag, por të dalë në botë. Në këtë rast liria e saj, në krahasim me lirinë e sarkofagut, edhe duke qenë disi e cinguar, është e një niveli më të lartë. Ajo është sipërane, pikërisht, sepse është e vështirë. Ajo ka brenda, bashkë me hijen e vdekjes, bukurinë e rrezikut. Dhe, dihet që bukuria, përkryerja artistike e një vepre bëjnë pjesë në lirinë e saj.

[B.K.] *Pse e depozituar në Francë tregimin Ikja e shtërgut, përderisa kishit guxuar të botonit në Shqipëri Pallati i Ëndrrave me një kundërtotalitarizëm të fuqishëm dhe të shumëanshëm?*

[I.K.] Arsyeja është e thjeshtë: në këtë tregim flitej fare haptaz për Shqipërinë komuniste. Siç e keni parë tekstin, atje gjithçka thuhet me emrin e vet.

[B.K.] *Tregimi iu është dukur i paplotë kur e keni riparë, apo keni shtuar në të diçka që nuk mundët ta shkruanit herën e parë?*

[I.K.] Kjo pyetje ka lidhje me fillimin e kësaj bisede. Kur e lexova pas kaq vitesh tregimin, si çdo gjë e mbyllur në sirtar, m'u duk disi i zbehtë. Sa kohë që Shqipëria ishte ende nën diktaturë, në ndërgjegjen time ai më dukej më i bukur. Me sa duket, rënia e diktaturës ia hoqi një farë favorizimi që i bënte tema e ndaluar. Ai doli kështu në kushte të barabarta me veprën tjetër letrare. Në këtë rast, s'bëra gjë tjetër, veç një rishikim, një pasurim artistik, gjëja më e natyrshme për çdo shkrimtar në botë.

[B.K.] *Në motërzimin e dytë është theksuar sidomos mbikqyrja dhe frika prej denoncimit. Për ç'arsye janë shtuar, pikërisht, këta dy përbërës?*

[I.K.] Nuk është aspak çështje kurajoje. Gjërat më të rënda dhe më të palejueshme për kohën janë thënë qysh në motërzimin e parë. Është thjesht një plotësim artistik.

[B.K.] *Kur rrëfimi është në vetën e parë, studiuesit shpesh besojnë ose kërkojnë në atë prozë fakte konkrete të jetës së shkrimtarit. Përveç shënimeve të Lasgushit Vizitat e zonjushës Ana në kullën time, që, siç pohoni te Ftesë në studio, i keni lexuar, a ka ndonjë fakt tjetër vetjak që e keni ndërfutur në tregim?*

[I.K.] Jo. As kam lexuar dhe, në të vërtetë, as do të doja që të dija më tepër për këtë histori. Ajo që ka lënë të shkruar Lasgush Poradeci është e pazëvendësueshme nga çfarëdolloj dëshmie tjetër.

[B.K.] Si është e mundur që gjithçka ishte e zgjedhur si me dorë në këtë histori, duke nisur që nga emri i gruas? - *thotë personazhi rrëfyes, kur merr vesh se ajo quhej Ana. Replika nuk është e qartë, por na kujtohen disa Ana me të cilat kjo heroinë ka tipare të përbashkëta. Ana Kern që, sikurse analizohet te Ftesë në studio, është zanafilla erotike e një poezie të famshme të Pushkinit. Ana Karenina e Tolstoit. Ana Krasniqi te Koncerti, një Ana kadareane për të cilën përherë kam menduar se mbart diçka nga dashuria e vetë shkrimtarit, pa të cilën është e vështirë të shpjegohet ndryshe ndjeshmëria e madhe me të cilën paraqitet. Mund të jepni ndonjë të dhënë për të kuptuar shprehjen enigmatike?*

[I.K.] Ka mundësi të ketë ndodhur kështu. Unë vetë ia kam bërë pyetjen vetes se përse kam qenë i joshur nga ky emër. Një kritik i ri shqiptar ka botuar gjithashtu një studim, ku shtron pak a shumë pyetjet tuaja. Po ju përgjigjem në mënyrën më të thjeshtë, më të singertë. Në Shqipëri, qoftë në gjimnaz, qoftë në universitet s'më ka qëlluar të kem patur shoqëri me ndonjë vajzë me emrin Ana, ose qoftë dhe Anita, Aneta, Ani, madje Hana. Ndërkaq, pikërisht, për shkak të vjershës së Pushkinit, ose të romanit të Tolstoit, kur kam qenë student në Moskë, atje ku vajzat me emrin Ana ishin të shpeshta, siç duket,

kjo ka qenë një farë shtyse për një vëmendje më të madhe ndaj tyre. Me fjalë të tjera, në qoftë se në një mbrëmje vallëzimi të qëllonte të njiheshe me dy vajza, me tërheqje pak a shumë të njëjtë, njëra prej të cilave quhej Ana e tjetra Svjetllana (një emër tjetër që ishte tepër i përhapur për shkak të vajzës së Stalinit), ti, po të ishe ithtar i letërsisë, emri Ana mund të të shtonte diçka në balancën e zgjedhjes. Siç mund ta merrni me mend, është fjala për pasione studenteske, kalimtare si era, që merrnin zanafillë ose prisheshin nga një shtysë e vogël. Më vonë, ato mund të shndërroheshin në një histori dashurie, por fillimet ishin zakonisht fare të rastësishme.

[B.K.] Pse të gjitha këto Ana, qoftë në veprën tuaj, qoftë në vepra të autorëve të tjerë që ju i interpretoni, paraqiten ose përfytyrohen sikur të jenë lindur për dashuri sublime të shkrimtarëve?

[I.K.] Kjo është vërtet tepër subjektive. Ju e dini se shkrimtari dashur pa dashur, me ndërgjegje ose thjesht i shtyrë nga një mbindjesi, mund të parapëlqejë emra njerëzorë, ashtu siç parapëlqen lule, peizazhe, gjendje të caktuara shpirtërore, stinë etj. Ndërkaq, emrat e njerëzve, në një farë mënyre, e kanë krijuar edhe ato një traditë, për të bërë më të lehtë lidhjen e personazhit letrar me lexuesin. Besoj se të gjithëve do të na dukej e vështirë që të zëvendësonim te Homeri emrin e Helenës, që shkaktoi fatkeqësinë në Trojë, me një emër tjetër (ta zemë, me emrin Elpiniqi, që është prapë grek, për të mos thënë Fatime ose Zymbyle). Ky i fundit, për shembull, ndonëse

i përket gjindjes sonë të dashur shqiptare dhe vjen nga bota fisnike e luleve, kam frikë se do t'ia prishte disi endjen një djaloshi të sotëm shqiptar, qoftë edhe në motërzimin e tij më të favorshëm: Lule.

Koha mund të ripërtërijë përherë ngarkesën emocionale të emrave. Mendoj se jeta ime njerëzore nuk më mjafton që të ndërroj disa parapëlqime të vjetra. Ndër to hyjnë edhe disa emra grash. Nërkaq, desha t'ju kujtoj se James Joyce, ai që kishte padurim të përmbyste shumë gjëra në letërsi, në muzg të krijimit letrar, në romanin *Finnegans Wake* iu rikthye emrit klasik *Ane*, në një nga personazhet më të njohur të tij, *Anna Livia*.

[B.K.] *Ikja e shtërgut (1986) është daktilografuar me gabime, të cilat ende nuk janë ndrequr. Është një mungesë vëmendjeje apo rrethanat nuk ju kanë lejuar për t'i ndrequr?*

[I.K.] Kur ju daktilografoni një tekst, që mendoni ta nxirrni fshehtëzi nga vendi juaj për ta depozituar në një kasafortë jashtë shtetit, gabimet ortografike janë gjëja e fundit që ju shqetësojnë. Të them të drejtën, ende nuk kam vënë re që ai tekst i shtypur më 1986 ka të tilla gabime.

Mars, 1999

IKJA E SHTËRGUT

Prill 1986
20 qershor 1986

IKJA E SHTËRGUT

Fluturoi dhe shtërgu i fundit

L. Poradeci

Ishte një mbasdite gri, nga ato prej të cilave s'priten veç gjëra të përsëritura, dhe sikur të mos mjaftonte kjo, ndërsa ecja nëpër Rrugën e Pishës, në anën tjetër të trotuarit pashë P. T., njeriun më të mërzitshëm që mund të mendohej. Ishte vonë për t'iu shmangur, qoftë edhe pafytyrësisht. Ngushtësia e rrugës ishte e tillë që e përjashtonte këtë. Ishte më mirë t'i bërtisje nga larg: *të urrej, i mërzitshëm!* se sa të bëje sikur s'e shihje.

Por, s'kishte kohë për filozofime. Si përherë; po aq mërzitshëm dhe buzëqeshës ai zbriti nga trotuari, duke e prerë rrugën pjerrtazi drejt meje.

S'u bë hataja, i thashë vetes. Do të përsëritësh ca *ç'kemi, si vete*, mekanikisht, idiotësisht, gjersa kjo torturë të mbaronte dhe secili të shkonte në punë të vet.

— Ç'kemi, si vete? — tha ai duke më dhënë dorën.

Qelbësirë, thashë me vete. Si s'e kuptove njëherë se ç'mërzi shkakton, kur e di që je i tillë, përse del në rrugë. Dhe nëse s'e di, aq më keq.

— Ç'kemi, si vete, — përsërita edhe unë fjalët e tij, pa kurrfarë kokëçarje se do të kuptonte shkujdesjen time. (Zaten një nga gjërat që më tërbonte tek ai njeri që pikërisht

moskuptimi i bezdisë që iu shkaktonte të gjithëve dhe që të gjithë ia tregonin haptaz.)

— Po ç'kemi gjë, — tha për të tretën ose të katërtën herë, ndërsa unë mendoja: si s'të ha mortja. Pse mban dheu të tillë.

— Hiç, ç'kemi gjë nga ty, — i thashë.

— Ç'të kemi? Të zakonshmet.

Kriminel, desha të thërrisja. Në një ditë të tillë, kaq të pashpresë për mua, kur kisha kaq nevojë për diçka të kundërt me monotoninë, ç'shans ogurzi të nxori përpara meje?

— Epo mirupafshim, — i thashë me po atë zë të njëtrajtshëm, i habitur dhe vetë se si shprehja *mos të pafsha më*, mund të konvertohej aq paq në të kundërtën e vet.

— Mirupafshim, — u përgjigj ai dhe më zgjati dorën, pas shtrëngimit të së cilës, gati sa nuk ia bëra *uf* mu në sytë e tij.

Kisha bërë dy tri hapa kur e dëgjova të më thërriste. Gati sa nuk iu besova veshëve; ishte e mundur që e keqja të ishte kaq këmbëngulëse? U ktheva sikur të më kishte shtirë pas shpine. Duhej të kisha diçka aq tepër të pambulueshme në fytyrë, sa që ai tha:

— Ç'pate?

— Ç'pate ti, — gati sa nuk i ulërita. Por ai, buzëqeshës si përherë, vazhdoi:

— Harrova të të them. E dëgjove? Lasgush Poradeci ka patur këtë verë një histori dashurie.

— Si?!

— Një histori dashurie pra. Thonë se desh u martua. Aq shumë më hutoi ajo që dëgjova sa që edhe ai e vuri re.

— Të bëri përshtypje, hë? Natyrisht është për t'u habitur. Në moshën tetëdhjetë vjeçare...

Atëhere ndodhi e pabesueshmja, më e pabesueshmja e gjithë veprimeve të marra që truri përfytyronte jashtë vullnetit, në orët e molisjes: u ktheva në kafenenë më të afërt për të pirë një kafe me P.T.

Kur dola nga kafeja, mbasditja dimërore, qielli, rruga, unë vetë ishim tjetër gjë. Çudi, sa të bëri përshtypje, më kishte përsëritur tri katër herë P.T., që për mua befasishte kthyer në një qenie normale, sikur të kishte kaluar brenda disa çasteve nga njeriu i Neandertalit në atë të kohës sonë. Nuk e mendoja kurrë se do të të bënte kaq shumë përshtypje.

Fjala *përshtypje* ishte fare e zbehtë për të dhënë atë çka provova në çastin e parë dhe që sa vinte aq më tepër më mahniste, më dehte, më trondiste. Madje, tani që isha ndarë prej P.T. dhe po ecja si i çakërdisur në bulevard, vala e përndezyes më kishte kapulluar më fort se kurrë. Lasgush Poradeci kishte patur atë verë një histori dashurie... I përsëritja e i përsëritja pa pushim ato fjalë që ishin si të mbështjella me një kumbim të harruar këmbanash.

Çudi, ti sikur s'ke çarë kokën për thashetheme të tilla, më kishte thënë P.T. Dhe unë s'i kisha kundërshtuar, vetëm kisha qeshur së brendshmi, ashtu siç më vinte të qeshja tani me atë fjalë të marrë.

Ishte e mundur që atij t'i ishte dukur ashtu... Ishte e mundur që të quhej me fjalë të zakonshme ajo që mua po më ngjante tani si një shenjë qiellore?

Kaq e fortë ishte kjo ndjesi sa që ngrita kokën, me shpresë se midis reve të palëvizshme të mbasdites, atyre reve, që gjer para ca kohe më qenë dukur si simboli i amullisë zyrtare, të gjeja vërtet shfaqjen e asaj shenje.

E kisha dashur përherë Lasgush Poradecin, me një dashuri të veçantë, që kishte gjithmonë brenda saj një brengë, një qortim. Por, edhe dashuria për të, edhe brenga dhe qortimi ishin të një përmase të veçantë, përtej të zakonshmes, gati-gati misterioze.

Po aq sa për vjershat e tij të bukura, ndoshta më shumë se për ato, kisha mall për kohën që kishte vdekur bashkë me të. Një kohë gjithashtu e papërcaktueshme lehtë (as kohë e mbretërisë, as e republikës, as e paraçlirimit), jo, një kohë tjetër, që mund të ishte brenda të triave, e mund të mos ishte askund. Më shumë se atë vetë, doja tek ai ëndrrën mallëngjyese për diçka të tretur. Të pakthyesmen. Të pamundurën.

Prej vitesh ishte dhe s'ishte. E kishin mënjanuar, mungonte në të gjitha ceremonitë. Dhe ndoshta pikërisht midis ceremonisë, prarimit të festës, niste qortimi për të. Por, edhe ai vetë, si çdo gjë tjetër që lidhej me të, ishte tjetër lloj, i përgjithshëm, flu, më tepër qortim ikonash...

Qe braktisur diçka që s'duhej braktisur. Qe shkelur me këmbë ëndrra. Nga sallat tona të mbledhjeve të ndriçuara brutalisht dukej sikur ai, munguesi i madh, kishte marrë prarimin e përkorë të llampadarëve të vjetër për të stolisur me të sarkofagun e vet.

Qe larguar tashmë. S'e kthenim dot nga udha... Nga sallat tona të mërzitshme plot me plenumë, fjalë të zhveshura e ligësi, largohet ngadalshëm arkivoli i tij prej

bronzi e ari. Por, bashkë me vetveten ai varroste diçka nga të gjithë ne.

Sa herë, si ata që shikojnë tempullin që po e mbulojnë ujërat, kishin pyetur plot dëshpërim: ishte vallë e pashmangshme kjo ikje e poetit? A s'kishte mundësi ta mbanin edhe pak? Jo për të, por për shpëtimin e vetes tonë.

Ë dinim të gjithë se ishte e pashmangshme, se ai s'kishte vend në këtë kohë dhe mendimi i hidhur se ndoshta edhe ne s'kishim vend, por me bërryle e me thonj e kishim kapur atë, na helmonte.

Pra, po i ikte Shqipërisë ky flori... Dhe ja, befas, tamam kur s'kishim më asnjë shpresë, poeti ishte përmendur, ëndrra kishte tundur krifën e saj rrezëlluese. Ai që, me gëzim të lig prej disave e me brengë prej nesh, quhej i vdekur, kishte bërë befas diçka të jashtëzakonshme, një veprim të gjallë, në raport me të cilin ne të gjithë ngjanim si të vdekur. Kishte bërë diçka të vërtetë prej poeti, jashtë kohe, të harruar, kavalereske, të dënueshme prej komiteteve të Partisë të rretheve, prej plenumeve, kongreseve, doktrinës.

Një lidhje dashurie në moshën tetëdhjetëvjeçare, në qytetin e vogël provincial, ku godina e Komitetit të Partisë ngjan më e madhe se kudo... Kjo ishte njëlloj si të dëgjoje këmbana katedralesh të zhdukura të shekullit të trembëdhjetë, atëherë kur Shqipëria kishte qenë ndoshta më fisnike.

Ishte një revansh kundër harresës së tij? Apo ishte më tepër revansh kundër kënetës së përditshme, mërzi së mbledhjeve, rregullave të realizmit socialist, romaneve skematike, plenumeve të pafundme plot me thirrje për

edukimin e shkrimtarëve, njohjen e jetës, detyrat përpara Partisë, militantizmi.

Natyrisht, sfida e tij, si çdo gjë që lidhej me të, e kapërcente atë vetë. Ishte revansh për Poetin në përgjithësi, kundër poshtërimit të tij, marrjes nëpër këmbë, fyerjeve, kinezërive, dënimeve, autokritikave poshtëruese, dërgimit për riedukim në bazë, në punë prodhuese, kanale. Pra, le ta merrnin vesh të gjithë se raca e poetëve ishte ende e gjallë në Shqipëri, se ata nuk i vriste dot, as i përulte, as i ulte kokën hirnosja e kohës.

Po ia bënte Shqipërisë këtë dhuratë duke ikur shtërgu i madh...

E kishim mbaruar së piri kafenë dhe P.T. për të katërtën, ndoshta të pestën herë më tha:

— Çudi sa përshtypje të bëri kjo gjë.

— Ah, vërtet... Po a të kujtohet emri i gruas?

— Emri? Po.. Më duket... Ah, po, më duket se e quanin Ana Jovan.

— Ana Jovan, — përsërita. Ana Jovan, thashë dy tri herë me vete. Si ishte e mundur që gjithçka ishte si e zgjedhur me dorë në këtë histori duke nisur nga emri i gruas?

Buzagaz ai vështronte filxhanin e tij, i habitur ndoshta ende se si kishte mundur të më hutonte.

— Po tjetër? — pyeta.

Ai ngriti supet dhe aty për aty pushoi së ekzistuari për mua. Ç'kërkoja tjetër prej tij? Duhej të nisesha vetë për në P., në vendin ku kishte ndodhur mrekullia, për të marrë vesh me themel gjithçka.

Rruga për në P. ishte e gjatë dhe e mërzitshme. Autobusi ndalonte herë pas here në qytetthe që ngjanin si të dambllorosur nga vapa. Në trotuare, përpara kafenesë ose berberhanes, në xhamin e së cilës qenë shkruar fjalët *Punë, edukim, vigjilencë*, kalimtarët e ndalur në vend ndiqnin me sy të topitur autobusin e kryeqytetit.

Më tutje kontrollet e policisë zunë të shpeshoheshin. Udhëtari përbri meje më ra lehtazi me bërryl, duke më treguar me kokë dy policët që po afroheshin.

— Aha, prapë kontroll, — i thashë unë dhe ktheva kokën drejt tij për të ndarë me të një farë pakënaqësie, natyrisht të tërthortë, tepër të tërthortë për këto kontrolle të shumta në mes të vapës. Por, për habinë time sytë e tij ishin si të veshur nga një avull admirimi. Afroi kokën te supi im, gati u rrënua i gjithi tek unë dhe përsëriti:

— Thonë se *i madhi* ka shkuar si çdo verë në P.

— Aha, — ia bëra unë. Ja përse gjithë këto...

I lumtur që e kishte ndarë me mua të fshehtë, ai bëri *po* me kokë.

— Lum ata që e kanë çdo verë midis tyre, — tha me ton ëndërrues.

— Natyrisht, — iu përgjigja.

Për fat njëri nga policët kishte hyrë ndërkaq në autobus dhe po kërkonte pasaportat.

Pas kontrollit autobusi vazhdoi rrugën dhe unë bëra sikur dremitja, që fqinji im të mos më fliste më. Mendimi i vetëm që më rrinte i ngulur në tru ishte që *ata të dy* ndodheshin në të njëjtin qytetth: ai, munguesi i madh, gjysmë i harruari, gati-gati fantazmë, dhe tjetri, i gjithëgjendshmi, me portretet dhe citatet që gëlonin kudo

të shkruara me bojë, me bar, me gurë, me trupa njerëzish gjatë manifestimeve sportive.

— Prapë kontroll, — tha fqinji im, me të njëjtën shprehje admirimi në fytyrë. Pa i hapur sytë unë futa dorën te xhepi i xhaketës për të nxjerrë pasaportën.

Në P. arritëm mbasdite. Si zakonisht, pas mbërritjes nga një rrugë e largët qytetthi ngjante edhe më i vdekur. Megjithë vapën e parakohshme sezoni klimaterik ende s'kishte nisur.

Pasi zumë vend në hotel, u vërtita një copë herë nëpër rrugën e vetme kryesore. Nën dritën e pamëshirshme të diellit vitrinat e dyqaneve ngjanin edhe më të varfëra. Në xhama, si kudo, kishte prapë parulla, madje më tepër se dy vjet më parë, kur kisha qenë këtu me pushime. Pantallona burrash. Kinkaleri. Edukim, vigjilencë.

Te hyrja e ndërtesës së Komitetit të Partisë dy policë qeshnin përgjumshëm me njëri-tjetrin.

Vapë dhe qytet i vogël provincial. Klubi i gjuetarëve. Berberhane. Qendër edukimi e bllokut Nr. 6. Asnjë shenjë se këtu kishte ndodhur mrekullia. Se Ana Jovan, një mbrëmje prilli... një mbrëmje të muajit prill...

Dyshimi se mos ajo çka më kishte thënë P.T. nuk ishte veçse një fantazi nga ato që trillohen shpesh në qytetet e vegjël, më mpiu për ca çaste.

E dija rrugën ku banonte poeti, dija edhe shtëpinë që ai ashtu si edhe gjithë të tjerët e quanin *kullë* për shkak të pamjes së veçantë të saj. Megjithatë nuk e di ç'më pengonte të shkoja drejt e atje. Në vend të rrugës së tij, këmbët po më çonin vetvetiu nga bregu i liqenit. Dhe atëherë m'u duk se e kuptova. Pothuajse e kuptova se ç'duhet të bëja. Përpara se të shkoja tek ai vetë duhej të

purifikohesha te liqeni, të cilit ai i kishte kushtuar disa nga vjershat e tij më të bukura, te plepat e Turizmit të vjetër, tek oborri plot lëmshk i manastirit mesjetar, të kthyer prej vitesh në depo djathi...

Kjo endje vazhdoi gati dy orë. Dallgët e liqenit ishin plot përndritje të fshehta smeraldi, thua se që nga fundi reflektonin ndriçime bizhush të varrosura, që një ditë do të hynin në punë përsëri. Kurse te këmbanorja gjysëm e rrënuar e manastirit, vendi ku qe shkullur këmbana ngjante sikur dhembte ende. Një paqe e trishtë, e gjerë dhe flu e kishte zotëruar gjithë qenien time dhe unë e kuptova se isha i përgatitur tashmë për të shkuar tek ai.

Po kapërceja sheshin përpara Komitetit të Partisë, kur dikush më thirri në emër. Pak më parë do ta ëndërroja një takim me një të njohur, por tani s'kisha nevojë për askënd.

Ishte regjisori i teatrit të kukullave, me të cilin isha njohur dy vjet më parë, gjatë pushimeve.

Pas fjalëve të para: si je, kam kaq kohë pa të parë, ç'e mirë të solli këndeje, u bë një heshtje bezdisëse.

— Po ç'kemi këndeje? — thashë unë për të dytën herë, tamam në atë mënyrë që e kisha inat te të tjerët.

Ai buzëqeshi.

— E ç'të kemi? Provincë është këtu, asgjë nuk ndodh. Të rejat ndodhin atje, te ju.

Ai ndoshta habitej që prisja diçka prej tij (më vonë ma tha këtë), ndërsa mua më kapi përsëri dyshimi: mos vallë fjalët që më tha P.T. në Tiranë s'ishin veçse një thashethem banal?

Do ta pyesja me siguri, sikur ai të mos fliste vetë për to.

— Ti pyet ç'kemi këndeje dhe unë habitem se si ju që

vini nga qendra e ngjarjeve, kërkoni të reja këtu në humbëtitë! Po ç'të tregojmë ne të shkretët? Monotoni, budallallëqe... Ja, para ca kohe Lasgushi desh na bëri një proçkë.

— A?

Ai lëvizi dorën, si të fshinte diçka, ashtu siç bëjnë zakonisht njerëzit kur me këtë lëvizje duan të nënvizojnë parëndësinë e asaj që porsa thanë dhe që s'meriton veç të fshihet aty për aty nga kujtesa.

Por, mua aq më bënte për atë gjest. Disa çaste isha si i dehur.

— Si? E paske dëgjuar? Paska ardhur lajmi gjer te ju? — Ai tundi kokën. — Pupu, na turpëroi të gjithëve.

— S'më duket se është turp, — thashë, — madje, do të thosha përkundrazi...

Ai më vështroi ngultazi.

— Kështu thotë dhe Sinani, piktori ynë, po unë i kam kundërshtuar. Kemi bërë dhe fjalë.

— S'është aspak turp, — vazhdova unë. — Përkundrazi, është nder për gjithë njerëzit e artit. Po, po, nder, dhe nder i madh bile.

— O zot, — ia bëri ai. — Tamam fjalët e Sinanit.

— Dhe përderisa gjëra të tilla ndodhin te ju, kjo do të thotë se ju s'jeni aspak humbëtitë. Ju qenki qendra, më kupton, qendra.

Ai më dëgjonte dyfish i habitur që unë mendoja ashtu dhe që Sinani kishte menduar njëlloj si unë.

Ishte e pamundur t'i thosha të vërtetën se përse më dukej e mrekullueshme ajo që kishte bërë Lasgushi, ndaj parapëlqeva të njëjtin arsyetim që kishte bërë Sinani dhe që regjisori më tregoi: artisti nuk plaket kurrë, arti të

mban të ri, më shumë se kushdo artisti ka nevojë për dashuri, që Gëte p.sh. në moshën 80 vjeçare etj. etj., rutinë e njohur romantike etj. Ishte e kuptueshme, madje tipike, që një piktor provincial të mendonte e të fliste ashtu në kafenenë gjysmë të boshatisur, kur ai me shokët e vet me anë të këtyre bisedave, ripërtërinin besimin e tyre te fuqia e artit kundër mospërfilljes dhe cinizmit të zyrtarëve të rrethit, që kujtoheshin për ta vetëm kur afroheshin festat dhe duhej organizuar koncerti zyrtar apo duheshin shkruar parullat.

S'më besohej se kuptonte më thellë. E shumta mund të ndjente turbull atë që mendoja unë dhe duke folur dehshëm për fuqinë përtëritëse të artit, Gëten, Ticianin, etj. diçka kundërshtonte nga banaliteti i përditshëm.

— Do të ta njoh Sinanin, ka për të të pëlqyer, — tha ai.

— Tani për tani më intereson ajo tjetra, — iu përgjegja.

U deshën disa çaste që ai (dhe unë bashkë me të), të kuptonim se ç'kisha dashur të nënkuptoj me fjalën *tjetra*, historinë e dashurisë së poetit apo thjesht femrën që merrte pjesë në të, Anën.

Ishin të dyja, dhe ishte gjithçka tjetër që lidhej me to.

Ai më tregoi se historia (pasi hoqi dorë nga fjala *proçkë*, ai e zëvendësoi atë me fjalën më kryeqytetase *skandal*, por duke parë se unë i prisha njëlloj buzët, e braktisi edhe atë duke u kënaqur me fjalën e ftohtë *histori*) pra, historia kishte filluar ose, më saktë, në muajin prill, Ana Jovan, mësuese e letërsisë, e ardhur në P. nga një qytet i veriut, katolike kishte qenë edhe më parë në shtëpinë e Lasgushit, por në muajin prill ajo nisi të qëndronte atje me orë të tëra, madje edhe mbrëmjeve. Pëshpërimat e

para për një lidhje dashurie midis tyre ashtu siç tingëlluan të pabesueshme për arsye të moshës së madhe të poetit, po aq vetvetëshëm u bënë të besueshme për shkak të aureolës së dikurshme të tij. Ndoshta kështu dhe do të vazhdonte kjo histori, e besuar prej disave dhe e pabesuar prej të tjerëve (formimi kulturor, malli për kohën e shkuar, karakteri dhe fati i secilit në jetë do të përcaktonin gjykimin ndaj saj), sikur të mos gjendej papritur një dëshmi që vërtetonte gjithçka. Dhe dëshmia ishte e pakundërshtueshme, përderisa që e shkruar nga vetë dora e poetit. Një fletore me rreth 50-60 faqe, e titulluar *Vizitat e zonjushës Ana Jovan në kullën time*. Në të që shkruar gjithçka: takimet me Anën, bisedat me të, çastet e dashurisë, projektet për martesë.

— E si u zbulua kjo?

— Eh, — ia bëri ai. — Ka një farë... si të them... ka një farë poshtërsie në këtë mes. Dy fqinje të reja, që një herë në javë shkojnë në shtëpinë e tij për të bërë punët, arritën t'ia marrin fshehurazi.

— Po ai?

— Ai, i tërhequr siç është në mendimet e tij, s'di asgjë. Ka mundësi t'i ketë harruar që i ka shkruar ato shënime.

— Domethënë fletorja është ende diku, jashtë shtëpisë së tij.

Ai bëri *po* me kokë dhe pa m'i hequr sytë tha:

— Unë mund të ta gjej, me kusht që të mos na hapësh ndonjë ngatërrësë. Domethënë të bërtasësh: meskinitet, poshtërsi e ku di unë.

— As që e kam ndërmend.

— Ti mund ta bësh nga nderimi që kë për të.

— Të jap fjalën.

Ai buzëqeshi i kënaqur vesh më vesh.

— Do të shohësh që edhe ne provincialët jemi të aftë për diçka... Pas një ore fletoren do ta kesh në duart e tua.

Pas një ore ajo ishte vërtet në duart e mia, e hollë, e brishtë si gjithë mrekullitë e mëdha, e mbushur me një shkrim të imtë karakteristik, që e njihja tashmë prej faksimileve të shumta që shoqëronin botimet e dikurshme luksoze të poetit. *Vizitat e zonjushës Ana Jovan në kullën time*. Tani që lexoja dhe e rilexoja papushim atë titull e kuptova se kisha dyshuar për të. Por, ai ishte i vërtetë, ashtu siç qe e vërtetë gjithçka. E vërtetë dhe e mahnitshme... Gjithë atë vit qe kërkuar më kot naftë. Të mposhtur nga hallet ekonomike njerëzit kërkonin t'i zbusnin ato, duke besuar para kohe se qenë zbuluar rezerva të reja kromi, se do të merrnin kredi nga Gjermania perëndimore, se Anglia do të kthente arin e mbajtur... Asgjë s'kishte ndodhur nga të gjitha këto. Qe zbuluar vetëm një thesar, por atë s'e dinte ende askush.

Këto po mendoja, kur zbrita në mbrëmje për të ngrënë darkë, në sallën e mërzitshme të restorantit. Ca volejbolistë që kishin ardhur për kushedi ç'olimpiadë, po hanin me zhurmë. Më tutje, ca njerëz me fytyra të zymta dhe veshje që i tregonin që atje tej se ishin të Ministrisë së Brendshme prisnin kamerierin. Ndërmend më rrinin fraza dhe pasazhe të tëra nga mrekullia që porsa kisha lexuar. A ishte vallë e mundur që, në një qytet të vogël si ky, të ndodheshin pranë e pranë njerëz, mendime e imazhe kaq tejet të largëta nga njëri-tjetri, sa që largësia midis tyre të mund të matej me vite dritë?

Përpara se të trokisja e kundrova për një kohë të gjatë kullën, duke u përpjekur të përfytyroja se si kishte hyrë në të Ana Jovan. Mëdyshja një copë herë te dera me qepenet e ulur, ashtu siç duhet t'i mbajnë gratë që hyjnë diku për të bërë mëkat, shtyrjen e kanatës, ngjitjen e lehtë të shkallëve të drunjta... Me kujdes, si të përpiqesha të mos e vrisja hijen që ajo mund të kishte lënë në ato shkallë, i ngjita shpejt e shpejt, ngaqë kështu më dukej se do të kërcisnin më pak.

Lasgushi më njohu menjëherë. Kishte po atë buzëqeshje të ftohtë si përherë, por me më shumë dritë (ishte vallë afërsia e vdekjes që duke ia ftohur, ia bënte megjithatë më të ndritshme gjithçka?). Mollëzat e lëmuara, sytë si mermer i plasaritur në formë rrezesh, gjithçka e tij ishte si e trajtuar nga një skalitës që punonte për përjetësinë.

— Faleminderit për këtë vizitë, — tha ai pa lëvizur nga minderi i vogël. Pas shpatullave të tij ishte dritarja dhe në të dukeshin degët e mollëve. Isha gjithë kujdes që të mos thosha ndonjë gjë të pamenduar, nga që kisha ndjesinë se ndodhesha në një botë kristallore, ku një lëvizje e pakujdesshme mund të thyente gjithçka. Po aq më tepër kisha frikë nga një bisedë rutinë: si keni qenë me shëndet etj.

— Duhet t'ju falenderoj unë që më pritët, — thashë, duke u matur, që në mënyrë sa më fine t'i thosha diçka për gëzimin që na shkaktonte të gjithëve duke qenë gjallë, midis nesh, ai, stolia më e çmuar...

Ai, si të ma kishte kuptuar mendimin, më ndërpreu:

— Kombin e bëjnë poetët, kjo dihet. Ata, qeveritarët, — ai bëri me dorë në një drejtim si të tregonte këndin ku gjendeshin, — kur bëjnë ndonjë punë, ndonëse bëjnë sikur na kanë harruar, te ne e kanë mendjen. Ç' do të thotë Lasgushi për këtë? Ç' do të thonë poetët?

— Është tamam ashtu, — i thashë.

Një copë herë ai tundi kokën duke vështruar duart e tij. ~~Buzëqeshja e ftohtë mezi e ndiqte kokën në lëvizjen e saj,~~ kështu që herë-herë mbetej si e varur në hapësirë.

— Bëjnë sikur na kanë harruar, po mendjen e kanë te ne, — përsëriti ngadalë. — Që nga ai, kryetari i tyre... Meqë ra fjala, ç'bën ai, gjallë është apo ka vdekur?

Mbeta i mahnitur nga këto fjalë. Të bëje këtë pyetje për udhëheqësin e vendit, për atë, portretet e të cilit mbushnin muret, dyqanet, libraritë të shoqëruara nga fjalë *rroftë, rroftë, rroftë*, ishte më tepër se habi. Dhe pyetjen e bënte pikërisht poeti i harruar, ai për të cilin zyrtarët e ndryshëm, duke përfshirë me siguri edhe vetë udhëheqësin, me ligësi, zili dhe padije, kishin qejf të thoshin: ç'bën vallë, rron apo ka vdekur?

Ishte njëzet vjet më i vjetër se udhëheqësi, megjithatë i qe dukur normale të bënte atë pyetje. Jo, s' ishte hakmarrje personale, por mospërfillje. Më tepër se hakmarrje ishte vizioni i tij i saktë për botën ku jetonte, të cilën ai qysh tani e llogariste sipas një kalendarit tjetër, atij të përjetësisë.

Bud poljégçe s poetom, sùdar!

Ky varg që nuk më kujtohej i kujt ishte, më erdhi befas në kujtesë me po atë intonacion, me të cilin lëshohet thirrja paralajmëruese: kujdes! Veç ajo thirrje nuk i drejtohej bashkëbiseduesit tim, por atij *tjetrit*.

Ishte treguar i egër me poetin. Madje më keq: pa guxuar t'ia bënte të keqen haptas, ia kishte bërë atë tërthorazi, me ligësi meskine, siç janë shpesh hakmarrjet e nxitura nga zilia.

Pas supeve të tij degët e mollëve lëkundeshin qetë. Në një ditë tjetër do të përpiqesha ta sillja bisedën për dashurinë, gjë që nuk ishte e vështirë me të! Por, pas asaj që tha, nuk mundja. Në një ditë tjetër, i shqetësuar nga fakti që ai s'po e përmendte dashurinë, do të dyshoja se e kishte harruar ndërkaq historinë e tij me Ana Jovan, se kishte hequr dorë prej aventurës, marrëzisë madhështore, dhe unë do të kisha qenë gati t'i bija në gjunjë, duke iu lutur në emër të të gjithëve që të mos e linte pa përmbushur atë mision. Mjeshtër, kalorës i përjetshëm, bëjeni, për ne të gjithë, për ... *e nsë dashunës botës sanë*. Në një ditë tjetër ndoshta do t'ia thosha këto, por atë paradite kur ai bëri pyetjen madhështore, gjithçka tjetër u zbeh përpara saj. Një hidhërim i brendshëm ia bënte edhe më të kthjellët shikimin.

— Tek *Iliada* e Homerit është një vend ku dielli zemërohet me Zeusin, nuk e di a të kujtohet, — tha pas pak. — Kështu pra, dielli zemërohet me tiranin dhe e di si e kërcënon? *Në ferr do zbres, do shndrit veç për të vdekurit!* — Ai buzëqeshi më ftohtë se më parë. — Ja pra, ç'kërcënim të hatashëm i bëri tiranit dielli. Të lerë vendin e vet në mes të qiellit dhe të zbresë atje ku s'ka hyrë kurrë një rreze drite, te të vdekurit, ku askush s'ka nevojë për të. Shkurt çdo gjë të bëhet së prapthi, me fjalë të tjera të vijë fundi i botës, apokalipsi... Të tillë kërcënim të tmerrshëm dhe jo naze zonjushash duhet të bëjë poeti.

Ai nuk m'i hiqte sytë e tij të akullt, me plasaritjet e

pamëshirshme prej mermeri në mes. Një copë herë të gjatë qëndruam kështu në heshtje, pastaj ai shtoi:

— Me sa kam lexuar prej teje, ti gjithashtu ke filluar të zbresësh te të vdekurit...

Pasditja ishte e hirtë, e vdekur, bosh, por ndoshta pikërisht nga që ishte e tillë unë nuk e kisha vështirë ta mbushja atë me gjithfarë përfytyrimesh. Pasi u enda te plepat e hotelit të vjetër dhe te oborri i manastirit të braktisur, qëndrova një kohë të gjatë te plazhi i shkretuar, sipër të cilit zogjtë, të vetmet gjëra që nguteshin në këtë qytet, vërtiteshin me klithma të paqeta. Pastaj ngadalshëm i rashë kryq e tërthor rrugëve, duke u përpjekur të marr me mend se në ç'parfumeri ndalej Ana Jovan për të blerë ato çka i duheshin, në kohën kur kishte filluar takimet me të...

Kështu, duke përfytyruar gjithfarë gjërash, më zuri mbrëmja. Që larg, në atë pjesë të qytetit ku qenë vilat e udhëheqësit, rrezëtinin dritëzat. Kurse kulla e poetit ndodhej në drejtimin tjetër. Kishte vite që pushonin të dy në një qytet, por nuk ishin takuar kurrë. Në vilat e të parit ftoheshin shpesh gjithfarë zyrtarësh e veprimtarësh të ndryshëm, veteranë, plaka, "artistë të merituar", veç ai, krenari e poezisë shqipe, s'qe ftuar asnjëherë.

Bud poljégçe s poetom, sùdar. Po nëqoftëse sunduesit i thuhej: ji m'i butë me poetin, sundues!, ç'do t'i thuhej vallë poetit kur të vinte ora e gjykimit të tij? Ji m'i butë me sunduesin, poet?! Ha, ha, ha.

Vizitat e sunduesit X në kullën time... Përderisa kjo nuk qe shkruar e s'do të shkruhej kurrë, do të thoshte se

tjetri ishte i humbur.

Nuk i hiqja dot sytë nga ajo rrezetimë e largët dritëzash. Më kishin treguar se pikërisht në ato ditë, ndërsa në Tiranë vazhdonte gjyqi kundër pjesëtarëve të familjes së rivalit të tij të përmbysur, në mbrëmje i sillnin videokasetat ku qe regjistruar gjithçka, dhe ai, bashkë me gruan, fëmijët, dhëndrrin dhe nusët qeshnin e talleshin tek i shihnin të lidhur me pranga, të rrënuar në baltë, qaramanë, kokëqethur, ata me të cilët pak kohë më parë i kalonin pushimet së bashku.

Në ferr do zbres, do shndrit veç për të vdekurit...

Hapat më çonin në rrugica të errëta, pa emër. Ai më kishte bërë një kompliment të madh, po a ishte vallë e vërtetë se unë kisha zbritur qoftë dhe përkohësisht atje? Bota e vdekjes ishte aq e pafundme dhe shtegtimi nëpër të duhej të ishte tepër i gjatë.

Ishte vonë, ndoshta mesnatë kur një nga rrugicat më nxorri në një lloj fushëtire. Ishte fresk, ndihej thellësia e qiellit dhe yjet e lartë si rrallë herë sipër tij. Në vjeshtë shtërgjet duhet të dukeshin që këtu tek niseshin për larg.

Fluturoi dhe shtërg i fundit madhështor me shpirt të gjorë.

Iku rëndë e i përmallshëm sipër maleve me dëborë...

Më erdhi të thosha: ku do të nisesh shtërg i madh dhe ku do të na lesh ne të gjorëve?

Prill 1986

20 qershor 1986

ky qytet
nga zyke e ku
das huzova
teadhetuar nga zyke e ku
Uzhgjerjeka

IKJA E SHTËRGUT

Tiranë, prill-qershor 1986
Paris, maj 1998

IKJA E SHTËRGUT

Ishte një mbasdite gri, nga ato prej të cilave s'priten veç gjëra të përsëritura dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, ndërsa ecja nëpër Rrugën e Pishës, në anën tjetër të trotuarit pashë R.P., njeriun më të mërzitshëm që mund të mendohej. Ishte vonë për t'iu shmangur, qoftë edhe pafytyrësisht. Ngushtësia e rrugës ishte e tillë që e përjashtonte këtë. Ishte më mirë t'i bërtisje nga larg: *të urrej, i mërzitshëm!*, se sa të bëje sikur s'e shihje.

Por, s'kishte kohë për filozofime. Si përherë, po aq mërzitshëm dhe buzëqeshës ai zbriti nga trotuari, duke e prerë rrugën pjerrtazi drejt meje.

S'u bë ndonjë gjëmë, i thashë vetes. Do të përsëritësh ca *ç'kemi, si vete*, mekanikisht, idiotësisht, gjersa kjo torturë të mbaronte dhe secili të shkonte në punë të vet.

— Ç'kemi, si vete? — tha ai duke më dhënë dorën.

I poshtër, thashë me vete. Si s'e kuptove njëherë se ç'mërzi shkakton. Kur e di që je i tillë, përse del në rrugë? Dhe në s'e di, aq më keq.

— Ç'kemi, si vete? — përsërita edhe unë fjalët e tij, pa kurrfarë kokëçarje se do të kuptonte shkujdesjen time.

— Asgjë, ç'kemi nga ty.

— Ç'të kemi? Të zakonshmet.

Kriminel, desh të thërrisja. Në një ditë të tillë, kaq të

pashpresë për mua, kur kisha kaq nevojë për diçka të kundërt me monotoninë, ç'shans ogurzi të nxorri përpara meje?

— Epo, mirupafshim, — i thashë me po atë zë të njëtrajtshëm, i habitur me vete se si shprehja *mos të pafsha më*, mund të tjetërsohej aq paq në të kundërtën e vet.

— Mirupafshim, — u përgjigj ai dhe më zgjati dorën, pas shtrëngimit të së cilës, gati sa nuk ia bëra *uf* mu në sytë e tij.

Kisha bërë dy-tri hapa kur e dëgjova të më thërriste. Gati sa nuk iu besova veshëve; ishte e mundur që e keqja të ishte kaq këmbëngulëse? U ktheva sikur të më kishte shtirë pas shpine. Duhej të kisha diçka aq tepër të pambulueshme në fytyrë, sa që ai tha:

— Ç'pate?

— Ç'pate ti, — gati sa nuk i ulërita. Por, ai, buzëqeshës si përherë, vazhdoi:

— Harrova të të them. E dëgjove? Lasgush Poradeci ka patur këtë verë një histori dashurie.

— Si?!

Zëri im ishte bërë aq i ngjirur saqë ai tha *çfarë?*.

— Si çfarë? — e pyeta.

Ne thamë dy-tri herë *çfarë*, si ata kalimtarët që ngatërrohen përballë njëri-tjetrit në trotuar, gjersa ai arriti të dilte nga pështjellimi.

— Ç'ka këtu për të mos kuptuar? Një histori dashurie, pra. Histori femrash, si i thonë.

Histori dashurie. Histori femrash, përsërita me vete. Desha t'i them: pa dale pak, si guxon ti, më i pashpresi i të gjithë njerëzve të sjellësh lajme të tilla. Lajme të tilla

në këtë dimër...

Ndërkaq mllefi kundër tij po dilte plotësisht nga qenia ime. Ishte pak a shumë njëlloj sikur t'i hiqje befaz armaturën e hekurt një ngrehine. Era më e lehtë, madje një puhizë e lehtë, mund të më përkulte përpara tij.

Vazhdonte të rrinte në trotuar duke buzëqeshur vesh më vesh, i ndërgjegjshëm ndoshta për ngadhënjimin e tij të vonë. *Elmbjeto L. h. Tepelen*

— Të bëri përshtypje, hé? Natyrisht që të bëri. Në moshën tetëdhjetë vjeçare...

Unë e vështroja ngultaz. Priste vallë që ta godisja ose t'i bija në gjunjë për t'i kërkuar ndjesë për përçmimin tim shumëvjeçar ose t'i bëja të dyja, gjersa të përfundonim të dy në polici apo psikiatri?

Nuk ndodhi as njëra, as tjetra, por një gjë e tretë më e pabesueshmja e gjithë marrëzive që truri im mund të përfytyronte në orët e shkrehjes.

Me zë të kujdesshëm, gati ledhatar, i thashë:

— A vjen të pimë një kafe?

Ai shqeu sytë. Unë vështrova mënjane për të mos e parë atë ndriçimin e tyre të papritur. Kishte vite që, me siguri, askush nuk e ftonte askund. I largoheshin nga sytë këmbët jo vetëm shokët e punës, por ata të fakultetit, ata që u kishte qëndruar pranë kur i kishte lënë e dashura, që iu kishte dhënë para hua, që iu kishte çuar lule në spital, i iknin pijanecët që kërkonin shok për të pirë, kushërinjtë e dytë, shokët e fëmijërisë, madje ata që s'largoheshin kurrë ose iknin të fundit: bashkëmasturbuesit te gremina të dielën...

Kurse unë jo vetëm që po e ftoja, por dora ime e kishte zënë ndërkaq për bërryli, duke e tërhequr drejt

hyrjes së kafenesë më të afërt, si të kisha droje se mos më ikte.

Kur dola nga kafeneja, mbasditja dimërore, qielli, rruga, unë vetë ishim tjetër gjë. Çudi, sa të bëri përshtypje, më kishte përsëritur tri katër herë R.P., që për mua befasishte ishte kthyer në një qenie të natyrshme, sikur të kishte kaluar brenda disa çasteve nga njeriu i Neandertalit në atë të kohës sonë. Nuk e mendoja kurrë se do të të bënte kaq shumë përshtypje.

Fjala *përshtypje* ishte fare e zbehtë për të dhënë atë çka provova në çastin e parë dhe sa vinte aq më tepër më mahniste, më dehte, më trondiste. Madje, tani që isha ndarë prej R.P. dhe po ecja si i ndërkrayer në bulevard, vala e përndezyes më kishte kapulluar më fort se kurrë. Lasgush Poradeci kishte patur atë verë një histori dashurie... I përsëritja e i përsëritja pa pushim ato fjalë që ishin si të mbështjella me një kumbim të harruar këmbanash.

Çudi, ti sikur s'ke çarë kokën aq fort për thashetheme të tilla, më kishte thënë R.P.

Në një rast tjetër do të ulërija: ti guxon të emërtosh me fjalën *thashetheme*, të vetmen gjë hyjnore që ka ndodhur vitet e fundit? Por, nuk kisha fuqi të zemërohesha. I bindur se ajo që kisha dëgjuar s'kishte qenë veç një shenjë qiellore, ngrita kryet, me shpresë se midis reve të palëvizshme të mbasdites, atyre reve që gjer para ca kohe më qenë dukur si simboli i amullisë zyrtare, të gjeja vërtet shfaqjen e saj.

E kisha dashur përherë Lasgush Poradecin, me një dashuri të veçantë, që kishte gjithmonë brenda saj një brengë, një qortim. Por, edhe dashuria për të, edhe brenga, dhe qortimi ishin të një përmase të veçantë, përtej të zakonshmes, gati-gati misterioze.

Po aq sa për vjershat e tij të bukura, ndoshta më shumë se për ato, kisha mall për kohën që kishte vdekur bashkë me të. Një kohë gjithashtu e papërcaktueshme lehtë (as kohë e mbretërisë, as e republikës, as e paraçlirimit), jo, një kohë tjetër, që mund të ishte brenda të triave e mund të mos ishte askund. Më shumë se atë vetë, doja tek ai ëndrrën mallëngjyese për diçka të tretur. Të pakthyeshmen. Të pamundurën.

Prej vitesh ishte dhe s'ishte. E kishin mënjanuar, mungonte në të gjitha ceremonitë. Dhe ndoshta pikërisht midis ceremonisë, prarimit të festës, niste qortimi për të. Por, edhe ai vetë, si çdo gjë tjetër që lidhej me të, ishte e tjetërfartë, e përgjithshme, flu, më tepër qortim ikonash...

Ishte braktisur diçka që s'duhej braktisur. Ishte shkelur me këmbë ëndrra. Nga sallat tona të mbledhjeve, të ndriçuara brutalisht, dukej sikur ai, munguesi i madh, kishte marrë prarimin e përkorë të llampadarëve të vjetër për të stolitur me të sarkofagun e vet.

Ishte larg tashmë. S'e kthenim dot nga udha... Nga sallat tona të mërzitshme plot me plenumë, fjalë të zhveshura e ligësi, largohej ngadalshëm arkivoli i tij prej bronzi e ari. Por, bashkë me vetveten ai varroste diçka nga të gjithë ne.

Sa herë, si ata që shikojnë tempullin që po e mbulojnë

ujërat, kishim pyetur plot dëshpërim: ishte vallë e pashmangshme kjo ikje e poetit? A s'kishte mundësi ta mbanin edhe pak? Jo për të, por për shpëtimin e vetes tonë.

E dinim të gjithë se ishte e pashmangshme, se ai s'kishte vend në këtë kohë dhe mendimi i hidhur se ndoshta edhe ne s'kishim vend, por me bërryle e me thonj e kishim kapur atë, na helmonte.

Pra, po i ikte Shqipërisë ky flori... Dhe ja, befas, pikërisht kur s'kishim më asnjë shpresë, poeti ishte përmendur, ëndrra kishte tundur krifën e saj rrezëlluese. Ai, që me gëzim të lig prej disave e me brengë prej nesh quhej i vdekur, kishte bërë befas diçka të jashtëzakonshme, një veprim të gjallë, në varësi me të cilën ne të gjithë ngjanim si të vdekur. Kishte bërë diçka të vërtetë prej poeti, jashtë kohe, të harruar, kavalereske, të dënueshme prej komiteteve të partisë së rretheve, prej plenumëve, kongreseve, doktrinës.

Një lidhje dashurie në moshën tetëdhjetëvjeçare, në qytetin e vogël provincial, ku godina e komitetit të partisë ngjante më e madhe se kudo... Kjo ishte njëlloj si të dëgjoje këmbana katedralesh të zhdukura të shekullit të trembëdhjetë, atëherë kur Shqipëria kishte qenë ndoshta më fisnike.

Ishte një hakmarrje kundër harresës së tij? Apo ishte më tepër revansh kundër kënetës së përditshme, mërzisë së mbledhjeve, rregullave të realizmit socialist, plenumëve të pafundme plot me thirrje për edukimin e shkrimtarëve, njohjen e jetës, detyrat përpara partisë, thjeshtësinë, militantizmin?

Si në një shtjellë kaotike m'u kujtuan mbledhjet e

shkrimtarëve, fyerjet, kinezëritë, vetëkritikat poshtëruese, dërgimi për riedukim në punë prodhuese, nëpër kanale. Dhe fjalët të jemi të thjeshtë, të jemi të thjeshtë, të jemi të thjeshtë. Këmishat sa vente e zhubroseshin, rrudhat në qafat e tyre merrnin një drejtim të papritur. Njiheshin aty për aty rrudhat e pleqërisë ose të sëmundjeve nga ato të diellit të kooperativave.

Shija e hidhur e mbledhjeve ku dënoheshin *autorët liberalë* mbetej për një kohë të gjatë në Klubin e Shkrimtarëve. Por, më të pashpresa se ato, ishin ca mbledhje të tjera, ku gjithçka ishte e pavërtetë, që nga kinsegabimet e autorëve gjer te kinsezymtia e fytyrës së anëtarit të Byrosë Politike, që ishte i pranishëm. Pritej ndoshta një racë e re mbledhjesh, ku do të kritikoheshin ndoshta ata që do të ngriheshin më pas në poste, e ndoshta një racë e katërt, ku një Zot e dinte ç'mund të bëhej.

Ndonëse gjithë ankth, në mbledhjet dramatike, njerëzit bashkë me tmerrin, provonin së paku një trazim të vërtetë. Kurse në mbledhjet e tjera, aty ku gjithçka ishte e rreme, dyfish e rreme ose e rreme brenda një të rreme tjetër, që i siguronte mbrojtjen në rast se lëvozhga e rrenës së parë thyhej, shkretëtira ishte e pambarim dhe në çdo drejtim ku të hidhje sytë nuk shihje veç qerthuj prej rëre.

Në një nga këto mbledhje kishte ardhur Lasgush Poradeci. Me një kostum të zi të modës së vjetër, me borselinë me strehë të gjerë të viteve tridhjetë, dukej sikur kishte dalë nga arkivoli.

Zuri vend në një kënd të sallës, i patrazuar nga askush, ngaqë, me sa dukej, ata që ishin përbri nuk e njohën. Gjithë vëmendja ishte thithur nga dy martirët e ardhshëm B.R. dhe T.K. Gjithë atë javë në kryeqytet nuk ishte

pëshpëritur veç për guximin e tyre. Guximin e tyre të marrë, ndoshta të parakohshëm, me siguri të tepruar, lidhur me heroin pozitiv në letërsi. Aq më tepër që vite më parë ishin kritikuar për lajthitje të ngjashme lidhur me atmosferën klimaterike në artin e realizmit socialist.

Ama, të guximshëm, s'ke ç'thua. S'thonë kot që raca e poetëve e ka një guxim të marrë!

Ishte kjo pëshpërimë, që e kishte bërë Poradecin të vishte kostumin e zi të ceremonive të vjetra e të vinte.

Heshtja në sallë ishte e thellë. Dhe fytyrat e dy të kritikuarve ishin dramatike, me një kuqëlim të lehtë midis, dhe e rreptë, si herën tjetër, në mos më shumë, ishte fytyra e anëtarit të Byrosë Politike, tek dëgjonte vetëkritikën e tyre. Ne, shokë, kemi qenë e do të jemi gjer në fund të jetës për heroin pozitiv, por gabimi ynë është se nuk e shpjeguem qartë idenë tonë se, ndonjë mungesë e tij, domethënë ndonjë e metë e tij njerëzore, si mirëbesimi i tepruar përshembull, mund të dëmtojë çështjen. Sa për klimën në romanet tona, për të cilën jemi kritikuar shtatë vjet më parë, ne kemi qenë e jemi për zotërimin e klimës pranverore, të qiellit blu socialist, kundër mjegullës e sidomos kundër shiut...

Shenja e parë e zbutjes në fytyrën e anëtarit të Byrosë Politike shkaktoi një valë mallëngjimi në sallë. Zemërgjerë, për besë, ishte partia.

Dy shkrimtarët plangprishës do të prisnin urimet në mbarim të mbledhjes, (ju lumtë, rrezikuat kokën për artin por, partia ama, ju kuptoi, ashtu si atëherë, shtatë vjet më parë, kur patët guximin e çmendur, pu-pu ç'guxim, marrëzi poetësh krejt, — të thoshnit se një re e vockël, një mjegullz e shtyrë nga puhiza e bënte të besueshëm

qiellin socialist). Dhe të gjithë e dinin tashmë, se në mbledhjet e ardhshme, kur kjo ngjarje dramatike të kujtohej si histori e shkuar, anëtari i Byrosë Politike, pakëz i thinjur, duke iu rënë supeve do t'u thoshte: eh, rebela keni qenë atëherë, ju kujtohet? Dhe ata, me fytyra të skuqura, pakëz të turpëruar do të përgjigjeshin përmes buzëqeshjes: i riu, si veriu, siç i thonë, shoku R...

Lasgush Poradeci nuk kishte arritur të shihte fundin paqtues të mbledhjes. Kishte dalë sapo kishte dëgjuar fjalët e para të vetëkritikës, pa rënë në sy, ashtu siç kishte hyrë, për t'u kthyer prapë në sarkofagun e vet.

Ndërsa ikte, në vend të fjalëve të mallkimit përsëriste ndoshta lutje për ne, ashtu si për gjithë ata që s'janë më. E quanin prej vitesh të vdekur, e me siguri, të tillë ai na quante ne: Ndriste hëna e ftohtë mbi grimcat e kuarcit në shkretëtirën ku gjithçka, madje edhe gabimet, ishin pa jetë.

Ajo mbledhje kishte qenë dalja e tij e fundit në publik. E kishim pritur kaq kohë rishfaqjen e tij, pa e menduar se a e meritonim. Kishim vrarë mendjen në ç'trajtë mund të ishte ajo, pa e gjetur dot kurrësi. Të gjitha shembulltyrat e jetës sonë ishin të papërshtatshme për të: mërzitë, zjarrmitë letrare, cic-micet tona, skandalet, madje prangat tona të mundshme. Që s'priste asgjë prej nesh, së paku qysh pas asaj mbledhjeje kur ishte rrënuar shpresa e tij e fundit, kjo dihej. Pyetja bëhej në se ne kishim të drejtë të prisnim diçka prej tij.

Ai vononte. Dhe befas, në ditën tonë më të shurdhët, në terrin, në *mosditën* tonë, ai kishte patur mëshirë për ne. Dhe, i shtyrë me siguri nga mëshira, ishte kujtuar të na bënte blatimin më të madh që mund të bëjë i vdekuri: një histori dashurie.

E kishim mbaruar së piri kafënë e dytë dhe R.P. për të katërtën, ndoshta të pestën herë më tha:

— Çudi sa përshtypje të bëri. Me të vërtetë çudi.

Desha t'i thërrisja: ah, ashtu të duket ty, e zakonshme, ajo që më the? Ashtu të duket, o peshk, o thnegël, që mbartje një unazë me diamant, pa ditur ç'mbartje, o zero, o tmerr?

Në të vërtetë të gjithë këto ishin hije të britmave. Hekurat e mllefrit kundër tij ishin të ndryshkura prej kohësh dhe në vend të atyre britmave kisha dëshirë, madje padurim, t'i thosha fjalë mirënjohjeje. T'i thosha pastaj se po ia bënte Shqipërisë këtë dhuratë, në ikje e sipër, shtërgu i madh. Se Lasgushi kishte bërë atë që kishte paralajmëruar prej vitesh në vjershat e tij: ishte ngjallur së vdekurish. Madje, ta ftoja që të këndonim bashkë alelujan.

Befas, një pikë dyshimi e preu si me thikë dehjen time.

— Në të vërtetë, më habite si rrallëkush, — i thashë.

— Veç desha të të pyes: a je i sigurtë për çka më the?

— Natyrisht, — u përgjigj.

— A mund të jetë një fantazi, një thashethem i zakonshëm?

Hutimi në sytë e tij ma ngriu gjakun. Desha t'i ulërij: dëgjo, ti ke të drejtë të mërzhitësh gjithë botën, të rrezosh madje ndërtesat me mërzhinë që rrezaton, por ti s'ke të drejtë, ti s'ke të drejtë...

— Dëgjo — i thashë, duke ia kapur dorën, — mos e di rastësisht, desha të them, mos të kujtohet emri i gruas?

Ai picërroi sytë.

— Emri? Po... Më duket... Ah, po, më duket se e quanin Ana G.

— Ana G., — përsërita. Ana G., thashë dy tri herë me vete. Si ishte e mundur që gjithçka ishte si e zgjedhur me dorë në këtë histori, duke nisur nga emri i gruas?

Buzagaz ai vështronte kupën e kafesë, i habitur ai vetë tani, ndoshta i trishtuar pakëz, që fati e kishte shpërblyer kaq vonë.

Vite më parë, kur njerëzit i shmangeshin mërzisë së tij, me siguri ka ëndërruar orën e hakmarrjes.

Mendimi për hakmarrjen më shqetësoi përsëri një grimë. Nuk e gjeja dot në ç'trajtë mund të shfaqej, por aty për aty m'u duk se e vetmja mbrojtje prej saj ishte të ngrihesha e të ikja sa më parë. Të ikja nga sytë këmbët si shokët e tij të fakultetit, si pijanecët që kërkonin shok për të pirë, si kushërinjtë, si të lënë prej grave, si masturbuesit të dielën te gremina...

Të shkëputesha prej R.P. sa nuk ishte vonë. Pa i dhënë mundësinë të më jepte goditjen hakmarrëse. Pa dëgjuar fjalë të tjera prej tij. Prej tij dhe prej askujt.

Të ikja pra, pa takuar askënd. Të nisesha drejt e ... atje. Në qytetin e vogël klimaterik. Atje ku...

Ai hapi gojën të fliste, të mbaronte ndoshta ndonjë frazë të lënë përgjysëm. Ose të thoshte një *ç'kemi tjetër?* vrasëse. Mos, thashë me vete. Pastaj, me zë të lartë thirra: *mos* dhe u ngrita. Nga lëvizja e vrullshme, kafeja e ftohur, që s'kisha arritur ta pija, u derdh.

Që nga rruga e pashë që më ndiqte me sy, i befasuar krejt, i vetëm si përherë. Por, unë s'kisha kohë për keqardhje. Mendja më rrihte në një pikë: të nisesha sa

më parë. Drejt e atje, te vendi ku kishte ndodhur mrekullia... çarja.

Rruga për në Pogradec ishte e gjatë dhe e mërzitshme. Autobusi ndalonte herë pas here në qytetthe, që ngjanin si të topitur nga vapa. Në trotuare, përpara kafenesë ose floktores, në qelqin e së cilës qenë shkruar fjalët *Punë, edukim, vigjilencë*, kalimtarët e ndaluar në vend ndiqnin me sy të mpirë autobusin e kryeqytetit.

Më tutje kontrollat e policisë zunë të shpeshoheshin. Udhëtari përbri meje më ra lehtëzi me bërryl, duke më treguar me kokë dy policët që po afroheshin.

— Aha, prapë kontroll, — i thashë unë dhe ktheva kokën drejt tij për të ndarë me të një farë pakënaqësie, natyrisht të tërthortë, tepër të tërthortë, për këto kontrolle të shumta në mes të vapës. Por, për habinë time sytë e tij ishin si të veshur nga një avull admirimi. Afroi kokën te supi im, gati u rrënuar i gjithi tek unë dhe pëshpëriti:

— Thonë se *i madhi* ka shkuar, si çdo verë, në Pogradec.

— Aha, — ia bëra unë. — Ja përse gjithë këto...

I lumtur që e kishte ndarë me mua të fshehtë, ai bëri *po* me kokë.

— Lum ata që e kanë çdo verë midis tyre, — tha me ton ëndërrues.

— Natyrisht, — iu përgjigja.

Për fat, njëri nga policët kishte hyrë ndërkaq në autobus dhe po kërkonte letërnjoftimet.

Pas kontrollit autobusi vazhdoi rrugën dhe unë bëra sikur dremitja, që fqinji im të mos më fliste më. Mendimi

i vetëm që më rrinte i ngulur në tru ishte që *ata të dy* ndodheshin në të njëjtin qytetth: ai, munguesi i madh, gjysmë i harruari, gati-gati fantazma dhe tjetri, i gjithëgjendshmi, me portretet dhe citatet që gëlonin kudo, të shkruara me ngjyrë, me bar, me gurë, me trupa njerëzish gjatë manifestimeve sportive.

— Prapë kontroll, — tha fqinji im, me të njëjtën shprehje admirimi në fytyrë. Pa i hapur sytë unë futa dorën te setra për të nxjerrë letërnjoftimin. Fqinji im e kishte nxjerrë ndërkaq, madje e kishte hapur te ndarja ku ishte fotografia dhe emri, për t'i lehtësuar punën policit. Por, me sa dukej, pikërisht ky zell i tepërt nuk i pëlqeu tjetrit. Pasi ia mori nga dora, e mbylli letërnjoftimin, pastaj nisi ta hapte vetë, duke e lagur gishtin e madh te goja, siç bënin shumica e policëve kur shfletonin diçka.

Polici i ktheu njëra pas tjetrës fletët e letërnjoftimit, ndërsa me bisht të syrit vështronte fytyrën e udhëtarit që sa vente e humbte sigurinë. Një farë trishtimi, përzier me hutim, fillim pakënaqësie a një buzëqeshje që kërkonte ndihmë prej të tjerëve, *te unë e gjeti të dyshojë ky njeri?*, krijuan një si dramë të vogël, më të kotsëkotshmen që kisha parë ndonjëherë.

Kontrolli më në fund mbaroi, autobuzi u nis dhe që jashtë pas qelqit të pluhurosur, pashë edhe një herë syrin e policit që vazhdonte të ndiqte plot dyshim e me një mllef krejt qesharak, fytyrën e fqinjit tim.

Një copë herë qesha së brendshmi, pastaj, si të vija në vete, i futa një të sharë vetes sime. Kisha një gjysmë ore që po tërhiqesha nga marrëzitë e kokëgdhëve, në vend që ta çoja mendjen në gjëra më të këndshme. Të mendoja për shembull se si Ana G. e bënte herë pas here këtë

rrugë, si gjatë kontrolleve, ajo e hapte çantën e vogël me pasqyrëz, për të nxjerrë që andej letërnjoftimin, si pastaj gishtat e saj me manikyrin e zbehtë në skajet (manikyrin e fithtë si vdekja që s'është larg) e mbyllnin prapë çantën dhe të gjitha këto kryheshin me ca lëvizje, që i bëjnë veç gratë që kanë njohur mëkatin.

Rruga automobilistike, e zënë si në kurth midis dy bokërrimave të zhveshura, të zgjonte pikëllim. Motori i autobusit rënkonte përherë e më fort në çdo kthesë dhe era e benzinës sa vente bëhej më e padurueshme. Ishte ndoshta vendi ku ajo arrinte ta mbyste përfundimisht parfumin e Ana G. Parfumin e zgjedhur me kujdes, të huajtur ndoshta nga një zonjë e moshuar, që i kishte shërbyer ndoshta një historie tjetër, në një tjetër epokë.

Shkarrëzimet e pikëlluara s'mbaronin që s'mbaronin dhe pikërisht midis tyre, ndodhi kontrolli tjetër. Këtë herë policët shoqëroheshin nga një civil, shenjë e sigurtë se këndeje e tutje kontrollet do të ishin më serioze. Heshtja e shurdhër që ra në autobus tregonte se udhëtarët e kishin ndjerë këtë. Fqinji im e zgjati me ndrojtje letërnjoftimin, por këtë herë gjithë vëmendja e policëve ishte përqëndruar mbi mua. Sytë e civilit kishin një ndriçim të lodhur, si të njeriut të paralajmëruar për diçka.

Përse shkoni në Pogradec?

Pyetja e tij ishte aq befasuese sa që e humba krejt. Ishte ndoshta e vetmja pyetje që nuk do të doja të më bëhej. E kisha më lehtë të jepja shpjegime për gjëra më të ndërlikuara, se sa për këtë pyetje të thjeshtë, përgjigjen e së cilës të tjerët e kishin me siguri në majë të gjuhës: shkoj për pushime ose te vajza që e kam arsimitare ose për dasmë a për mort.

Nuk e dini përse shkoni? Tha ai me një buzëqeshje shpotitëse. Siç duket, pa dashur, kisha ngritur supet, si gjithë njerëzit kur duan të thonë *nuk e di*.

Fqinji im po shqyente sytë, i paduruar me siguri për të thënë arsyen e vet. Truri im i mpirë s'më jepte asnjë përligjje për këtë udhëtim. Një vjegë, qoftë dhe naive.

Udhëtarët përbri kishin kthyer kryet. Ishte e mundur që njeriu të mos e dinte përse nisej për rrugë? Eja të mos dyshosh pastaj.

Sytë e civilit bëheshin përherë e më zhbirues. Pyetjen e tij të dytë, atë më të tmerrshmen, e ndjeva të shfaqej në to, si i mbyturi nën sipërfaqen e ujit. E njihni Ana G.?

Ja pra ç'na qenkësh.

Si çikriku që lëshohet befas, truri im, nga mpirja kaloi në një vërtitje marramendëse. Ja, pra, ç'na qenkësh. Ai qolja i neveritshëm R. P., ajo kandër e rëndomtë, që me të cilën ishim mahnitur të gjithë, paskësh qenë një provokator i rrezikshëm. Vite me rradhë na i kishte hedhur, na kishte përqeshur të gjithëve, na kishte futur në kurth.

O Zot, mendova, si kishte arritur kaq shpejt të më denonconte?

Pyetjet e tjera në sytë e civilit, i shihja tani qartë. Ti kujton se na kanë shpëtuar udhëtimet e saj? Udhëtimet misterioze të Ana G., sidomos në stinën e pushimeve, atëhere kur Udhëheqësi ndodhej në Pogradec? Dhe atë historinë e saj me Lasgush Poradecin, kujton se e kemi gëlltitur?

Desha t'i them: edhe atë histori e paskeni shpikur ju? Si gjithçka tjetër, si rebelët në mbledhjet e shkrimtarëve, si sabotimet në naftë... Por, ai ma preu fjalën me egërsi:

atë e keni shpikur ju.

Një copë herë u ngatërruam. Ne. Ju. Dyshimi se Ana G. mund të kishte synime të rrezikshme ndaj Udhëheqësit shpalosej tani haptaz. Manikyri në gishtat e saj m'u përfytyrua një grimë si i përgjakshëm.

Kurse ti u mahnite pas hamendjes se ajo vjen te poeti. Sepse, kështu ju pëlqen, t'i vini poetët në rivalitet me udhëheqësit.

Sipas tij, në vend që të vija në qytetin e vogël klimaterik për të admiruar që larg Udhëheqësin, ashtu siç bënin qindra njerëz, që ishin gati të gdhieshin e të ngryseshin ditë e net, madje krejt stinën e verës, për ta parë qoftë edhe një herë, mua më ishte prishur mendja nga një trill i poetit të çmendur, madje e kisha marrë për shenjë qiellore.

Një grimë gjithçka m'u mjegullua në kokë. Nuk e kapja dot arsyetimin e tij: që Ana G. vinte në Pogradec jo për poetin, por për Udhëheqësin, kjo ishte e qartë. Ajo që nuk kuptohej ishte në se vinte për të dashuruar apo për të vrarë.

Ky civil është i çmendur, mendova. Prite kur të më thotë se ajo vjen për të dyja.

Në të vërtetë, kur një grua shkonte te një burrë, në të shumtën e rasteve shkonte për të dyja. Por, nuk e besoja kurrë që mendja e tij prej polici të ishte e aftë për stërhollime të tilla.

Për habinë time, hija e tij s'e kishte më peshën e pakmëparshme, kur kishte hipur në autobus. Ai sikur ta ndiente këtë, më vështroi një grimë ndryshe. Në sytë e tij kishte një farë vuajtje, gati-gati lutje. Ata sy dukej sikur më thoshin: vazhdo edhe pak të kesh përfillje... domethënë

frikë. Së paku, sa të dalim nga kjo humbëtirë.

Desha t'i them: mos do të thuash se përgojova benzinën e shtetit, bashkë me premtimet e naftëtarëve për tejkalimin e planit, për nder të Kongresit 8? Me siguri të ka shkuar mendja ta shkruash në raportin tënd edhe këtë. Të shkruash se *“ai (domethënë unë) aty, midis kilometrit 137-141 e fajësoi erën e benzinës, që kishte mbytur parfumin e Ana G., pa e fshehur nostalgjinë për këtë të fundit”*.

Tani isha aq shpërfillës sa që mendja të më shkëputej prej tij, për të shkuar në qytetin verior, prej nga Ana G. nisej me autobus për në Pogradec. E përfytyrova duke vënë parfumin përpara pasqyrës së vjetër me skajime bronzi, përbri ikonës së ftohtë të besimit tjetër.

Ky largimi im sikur e rrënoi përfundimisht njeriun e policisë së fshehtë. Mjaftoi një lëkundje e fortë e autobusit, që ai të shpërbëhej krejt dhe unë të zgjohesha nga dremitja.

Ishte po ajo rrugë e mërzitshme gjithë pluhur, me gurët kilometrikë të rrallë, shumica të anuar nga ndonjë goditje. Njëri prej tyre, i shkukur me sa dukej e i vendosur prapë nga një dorë e pakujdesshme kryengulthi, më bëri të qesh me vete. Numri 147, duke e lexuar së prapthi **L7I** jo vetëm që e zgjaste rrugën pesë herë më shumë, por i jepte një kah të kundërt, duke bërë lëmsh çdo hetim të mundshëm.

Pak më tutje, në hyrje të një qyteze kishte prapë pllakate, shumica me shkronja të çngjyrosura dhe midis tyre, midis thirrjeve për besnikëri ndaj shtetit, syçelësi dhe moral të pastër, kishte vërtet premtime punonjësish në prag të Kongresit të 8. (Premtimet e Ana G. për dashuri të përjetshme...)

E shkunda kryet për të mos dremitur përsëri. Kisha dëgjuar se ishte e rrezikshme: nga një frenim i befte mund të të thyhej arzi i qafës.

Në Pogradec arritëm mbasdite. Si zakonisht pas mbërritjes nga një rrugë e largët, qytetthi ngjante edhe më i vdekur. Megjithë vapën e parakohshme, stina turistike ende s'kishte nisur.

Pasi zura vend në hotel, u vërtita një copë herë nëpër rrugën e vetme kryesore. Nën dritën e pamëshirshme të diellit vitrinat e dyqaneve ngjanin edhe më të varfëra. Në qelqe, si kudo, kishte prapë parrulla, madje më tepër se dy vjet më parë, kur kisha qenë këtu me pushime. Pantallona burrash, kinkaleri. Edukim, vigjilencë, shampo.

Te hÿrja e ndërtesës së Komitetit të Partisë dy policë qeshnin përgjumshëm me njëri-tjetrin.

Vapë dhe qytet i vogël provincial. Klubi i gjuetarëve. Berberhane. Qendër edukimi e bllokut Nr. 6. Asnjë shenjë se këtu kishte ndodhur mrekullia. Se Ana G., një mbrëmje prilli... një mbrëmje të muajit prill...

Dyshimi se mos e gjithë kjo histori nuk ishte veçse një fantazi nga ato që trillohen shpesh në qytetet e vegjël, m'u rikthye këtë herë në një trajtë tinzare. R. P. mund të ketë qenë i sinqertë (u desh një farë kohe që të më hiqej shija e keqe për të), por thashethemet e rralla, ashtu si lumenjtë e mëdhenj, e kishin zakonisht burimin larg. E kisha lehtë ta përfytyroja zanafillën e saj në një zonë më të pastër, pranë liqeneve të kthjellët alpinë, p.sh. atje ku lindnin rungajat, por arsytimi i ftohtë ma sprapste këtë

hamendje. Nga bjeshkët zbrisnin fantazira të një tjetër natyre. Kjo kishte lindur, me sa dukej, këtu, mu midis mërzisë së pashpresë të qytetit të vogël, në zyrat e zhveshura të të cilit, gra me flokë të prerë shkurt, duke e ngritur dorezën e telefonit me lëvizje të prera shqiptonin në mënyrë edhe më të prerë fjalët: shoku Gafur lajmëroi për një mbledhje të ngutshme, kurse nga ndërtesa e postës nuk arrinte kurrë një letër dashurie, ngaqë të gjithë e dinin se letrat hapeshin.

Tek vështroja ndërtesat e reja të shëmtuara, e merrja me mend se sa e huaj e skandaloze duhej të ishte këtu Ana G.

Tani nuk e gjeja dot nëse uria e qytetit e kishte shpikur atë si një vajtim për vetveten apo Lasgush Poradeci, në pamundësi për t'i ndërtuar këtij qytetthi një kishëz a një krua, siç bënë shpesh shqiptarët e njohur, apo në pamundësi për t'i shndërruar arkitekturën, i kishte dhënë Ana G. Ia kishte dhënë si dhuratë a si ndëshkim, këtë s'mund ta dinte askush.

E dija rrugën ku banonte poeti, dija edhe shtëpinë që ai, ashtu si edhe gjithë të tjerët, e quante *kullë* për shkak të pamjes së veçantë të saj. Megjithatë, nuk e di ç'më pengonte të shkoja drejt e atje. Në vend të rrugës së tij, këmbët po më çonin vetvetiu nga bregu i liqenit. Dhe atëherë m'u duk se e kuptova. Pothuajse e kuptova se ç'duhet të bëja. Përpara se të shkoja tek ai vetë duhej të pastroheshja së brendshmi te liqeni, të cilit ai i kishte kushtuar disa nga vjershat e tij më të bukura, te plepat e Turizmit të vjetër, te oborri plot lëmyshk i manastirit mesjetar, të kthyer prej vitesh në depo djathi...

Kjo endje vazhdoi gati dy orë. Dallgët e liqenit ishin plot përndritje të fshehta zmeraldi, thua se që nga fundi

pasqyronin ndriçime bizhush të varrosura, që një ditë do të hynin në punë përsëri. Kurse te këmbanorja gjysëm e rrënuar e manastirit, vendi ku qe shkullur këmbana ngjante sikur dhembte ende. Një paqe e trishtë, e gjerë dhe flu e kishte dorëzuar gjithë qenien time dhe unë e kuptova se isha i përgatitur tashmë për të shkuar tek ai.

Po kapërceja sheshin përpara Komitetit të Partisë, kur dikush më thirri në emër. Pak më parë, do ta ëndërroja një takim me një të njohur, por tani s'kisha nevojë për askënd.

Ishte regjisori i teatrit të kukullave me të cilin isha njohur dy vjet më parë, gjatë pushimeve.

Pas fjalëve të para, si je, kam kaq kohë pa të parë, ç'e mirë të solli këndeje, u bë një heshtje bezdisëse.

— Po ç'kemi këndeje? — thashë unë për të dytën herë, pikërisht në atë mënyrë që nuk e duroja dot te të tjerët.

Ai buzëqeshi.

— E ç'të kemi? Provincë është këtu, asgjë nuk ndodh. Të rejat ndodhin atje, te ju.

Ai ndoshta habitej që prisja diçka prej tij (më vonë ma tha këtë), ndërsa mua dyshimi më kapi përsëri, këtë herë i egër, çnjerëzor. Nuk kishte, me sa dukej, histori dashurie të poetit, nuk kishte Anë G., pasqyrë bronzi dhe parfum të një epoke tjetër. Kishte vetëm vapë dhe erë të benzines, që nuk të shqitet nga rrobat ditë të tëra. Dhe, natyrisht, premtime në pragje kongresesh.

— Ti pyet ç'kemi këndeje, dhe unë habitem se si ju që vini nga qendra e ngjarjeve, kërkonti të reja këtu në humbëtirë! Po ç'të tregojmë ne të shkretët? Monotoni, kotësira... Ja, para ca kohe Lasgushi desh na bëri një proçkë.

— A?

Ai lëvizi dorën, si të hidhte mënjanë, ashtu siç bëjnë zakonisht njerëzit kur me këtë lëvizje duan të nënvizojnë parëndësinë e asaj që porsa thanë dhe që s' meriton veç të hiqet aty për aty nga kujtesa.

Pa ia vënë veshin asaj lëvizjeje shpërfillëse, asaj që në një rast tjetër do të më bënte t'i hidhesha në grykë (si guxon ti, karafil kukullash, të flasësh kështu për bëmat e poetit) u përndeza aty për aty. I çliruar nga pesha e dyshimit, mezi e mbajta veten që t'i hidhesha në qafë.

Ai vazhdonte të tundte kryet e të qeshte si guak.

— E paske dëgjuar, pra, edhe ti? Paska ardhur lajmi gjer te ju? Ai tundi kokën. — Pupu, na turpëroi të gjithëve.

— S'më duket se është turp, — thashë, — madje, do të thosha përkundrazi...

Ai më vështroi ngultazi.

— Kështu thotë dhe Gjergji, piktori ynë, po e kam kundërshtuar. Kemi bërë dhe fjalë.

— S'është aspak turp, — vazhdova unë. — Përkundrazi është nder për gjithë... Desha të them, për të gjithë ne... njerëzit e artit.

— O Zot, — ia bëri ai. Krejt fjalët e Gjergjit.

— Dhe përderisa gjëra të tilla ndodhin te ju, kjo do të thotë se ju s'jeni aspak humbëtirë. Ju qenki qendra, më kupton, qendra.

Ai më dëgjonte dyfish i habitur që unë mendoja ashtu dhe që Gjergji piktori kishte menduar njëlloj si unë.

Ishte e pamundur t'i thosha të vërtetën se përse më dukej e mrekullueshme ajo që kishte bërë Lasgushi, ndaj parapëlqeva të njëjtin arsyetim që kishte bërë piktori. E dija pak a shumë ç'bisedonin artistët e pakënaqur në kafenetë gjysëm të zbrazëta të provincës. Të fyer prej

shpërfilljes së zyrtarëve të rrethit, që kujtoheshin për ta veç kur afroheshin festat dhe duhej bërë koncerti zyrtar apo zbukurimet e qytetit, pasi shfrynin një copë herë përpara gotës së konjakut, i jepnin zemër vetes, duke kujtuar paraardhësit e mëdhenj: famën e tyre, nderimin e princave për ta, gratë që kishin patur. Vinin pastaj, me siguri, të thënmet e shpenzuara pa mëshirë, në të gjitha pasdarmat plot tym cigareje, për nevojën e artistit për dashuri, për fuqinë përtëritëse të saj, sidomos në muzg të jetës. Gjersa si pasojë e shkallëzimit të përndezjes, vinte pastaj fraza e stërshpenzuar, ajo pas së cilës të vinte ose të ulërije ose t'ia mbathje sa më parë: më thuaj të lutem, a kujtohet kush se cili ka qenë ministër i kulturës në kohën e Shekspirit?

S'më besohej se piktori Gjergj shkonte më larg. E shumta mund të ndjente turbull atë që mendoja unë dhe, duke folur dehshëm për fuqinë përtëritëse të artit, Gëten, Ticianin etj., diçka kundërshtonte nga hirnosja e përditshme.

— Do të të njoh me Gjergjin, ka për të të pëlqyer, — tha ai.

— Tani për tani më intereson kjo tjetra, — iu përgjegja. U deshën disa çaste që ai (dhe unë bashkë me të), të kuptonim se ç'kisha dashur të nënkuptoj me fjalën *tjetra*, historinë e dashurisë së poetit apo thjesht femrën që merrte pjesë në të, Anën.

Ishin të dyja, dhe ishte gjithçka tjetër që lidhej me to. Ai më tregoi se historia, (pasi hoqi dorë nga fjala *proçkë*, ai e zëvendësoi atë me fjalën më kryeqytetase *skandal*, por duke parë se unë i prisha njëlloj buzët, e braktisi edhe atë, duke u kënaqur me fjalën e ftohtë

histori), pra, historia kishte filluar në muajin prill, kur Ana G., e ardhur në Pogradec nga një qytet katolik i veriut, nisi të qëndronte me orë të tëra, madje edhe mbrëmjeve, në shtëpinë e poetit. Pëshpërimat e para për një lidhje dashurie midis tyre, ashtu siç tingëlluan të pabesueshme për arsye të moshës së madhe të poetit, po aq vetvetishëm u bënë të besueshme për shkak të aureolës së dikurshme të tij. Ndoshta kështu dhe do të vazhdonte kjo histori, e besuar prej disave dhe e pabesuar prej të tjerëve, pra kështu do të gjëllonte, sipas piktorit Gjergj, duke i ndarë njerëzit, ata që prej vitesh nuk ishin ndarë për asgjë, në dy grupime të mëdha. Gjithmonë sipas piktorit, do të vazhdonte kështu gjer në vdekjen e poetit, e me siguri, pas vdekjes së tij, sikur të mos gjendej papritur një dëshmi që vërtetonte gjithçka. Dhe dëshmia ishte e pakundërshtueshme, përderisa që e shkruar nga vetë dora e poetit. Nje fletore me rreth 50-60 faqe, e titulluar *Vizitat e zonjushës Ana G. në kullën time*. Në të që shkruar gjithçka: takimet me Anën, bisedat me të, çastet e dashurisë, projektet për martesë.

— E si u zbulua kjo?

— Eh, — ia bëri ai. — Ka një farë ... si të them ... ka një farë dhelpërie në këtë mes. Dy fqinje të reja, që një herë në javë shkonin në shtëpinë e tij për të bërë punët, arritën t'ia marrin fshehurazi.

— Po ai?

— Ai, i tërhequr siç është në mendimet e tij, s'di asgjë. Ka mundësi t'i ketë harruar që i ka shkruar ato shënime.

— Domethënë fletorja është ende diku, jashtë shtëpisë së tij.

Ai bëri *po* me kokë dhe pa m'i hequr sytë tha:

— Unë mund të ta gjej, me kusht që të mos na hapësh ndonjë ngatërrësë. Domethënë të bërtasësh: meskititet, poshtërsi e ku di unë.

— As që kam ndërmend

— Ti mund ta bësh nga nderimi që ke për të.

— Të jap fjalën.

Ai buzëqeshi i kënaqur vesh më vesh.

— Do të shohësh që edhe ne provincialët jemi të aftë për diçka... Pas një ore fletoren do ta kesh në duart e tua.

Pas një ore ajo ishte vërtet në duart e mia, e hollë, e brishtë si gjithë mrekullitë e mëdha, e mbushur me një shkrim të imtë karakteristik, që e njihja tashmë prej faksimileve të shumta, që shoqëronin botimet e dikurshme luksoze të poetit. *Vizitat e zonjushës Ana G. në kullën time*. Tani që lexoja dhe e rilexoja pa pushim atë titull e kuptova se sa fort, se sa dëshpërimisht kisha dyshuar për të. Por, ai ishte i vërtetë, ashtu siç ishte e vërtetë gjithçka. E vërtetë dhe e mahnitshme... Gjithë atë vit ishte kërkuar më kot naftë. Të mposhtur nga hallet ekonomike njerëzit kërkonin t'i zbusnin ato, duke besuar para kohe se qenë zbuluar rezerva të reja kromi, se do të merrnin kredi nga Gjermania Perëndimore, se Anglia do të kthente më në fund arin e mbajtur qysh nga Lufta e Dytë Botërore... Asgjë s'kishte ndodhur nga të gjitha këto. Ishte zbuluar vetëm një thesar, por atë s'e dinte ende askush.

Këtë po mendoja kur zbrita në mbrëmje për të ngrënë darkë në sallën e mërzitshme të restorantit. Ca volejbolliste që kishin ardhur për kushedi ç'olimpiadë po hanin me

zhurmë. Më tutje ca njerëz me fytyra të zymta dhe veshje që i tregonin që atje tej se ishin të Ministrisë së Brendshme prisnin kamerierin. Ndër mend më rrinin fraza dhe copa të tëra nga mrekullia që porsa kisha lexuar.

Pas darke u ngjita në dhomën time. Qëndrova ca kohë mbi shtrat, pastaj dola në ballkon. Liqeni ngjante i zi e i frikshëm. Kështu e mbaja mend përherë në netët pa hënë. Dukej sikur në atë zi të pabesueshme përgatiste kaltërsinë e tij të nesërme. Thuhej se UNESKO-ja po hartonte një projekt për mbrojtjen e tij. Asnjë Pen-klub shkrimtarësh evropianë nuk ishte kujtuar kurrë për Lasgush Poradecin.

Kisha ftohtë. U futa në dhomë, por mpirja e shkaktuar prej greminës së zezë të ujit s'më linte të kthjellohesha. Tani po më kujtohej se kostumi dhe borselina e zezë e Lasgush Poradecit, në daljen e tij të fundit, jepte shqetësim të ngjashëm. Nën atë borselinë të zezë kishte ndërmenduar ndoshta vjershat më të bukura. Dhe mendimet për Ana G., natyrisht.

E përfytyrova prapë në autobusin e mërzitshëm ndërqytetas, por tani kisha përtesë të ndaja ato që kishin ndodhur vërtet, nga ato ç'kisha menduar. E përzier me të m'u kujtua një novelë e botuar kohë më parë në Moskë, ku tregohej për një vajzë sovjetike, të dashuruar pas Aleksandër Bllokut të vdekur. Do t'i kesh të gjitha më pas, thashë me vete. Do t'i kishte pa dyshim të gjitha më pas, por s'do t'i merrte vesh kurrë, ashtu si liqeni që s'do t'i dinte kurrë vjershat që ai i kishte kushtuar.

Ti shpejtove për ta arritur ende gjallë, mjellmë e veriut, i thashë me vete Ana G. Më pas, kur ne të mos jemi më, gjithçka do të jetë më e lehtë. Kurse ti pate mendimin e ndritur të shpëtoje...

Përpara se të trokisja e kundrova për një kohë të gjatë kullën, duke u përpjekur të përfytyroja se si kishte hyrë në të Ana G. Mëdyshja një copë herë te dera me qepallat e ulura, ashtu siç duhet t'i mbajnë gratë që hyjnë në një vend ku s'duhet, shtyrjen e flegrës së portës, ngjitjen e lehtë të shkallëve të drunjta... Me kujdes, si të përiqesha të mos e vrisja hijen që ajo mund të kishte lënë në ato shkallë, i ngjita shpejt e shpejt, ngaqë kështu më dukej se do të kërcisnin më pak.

Lasgushi më njohu në çast. Kishte po atë buzëqeshje si vitin që shkoi, veçse më të ftohtë, apo ndoshta mua m'u duk ashtu ngaqë, sipas gjithë klisheve të kafeneve të artistëve, (rob i të cilave doja apo s'doja), kisha rënë, prisja t'i gjeja në fytyrë shenjat rinuese të dashurisë. Por ai, ashtu si gjithçka tjetër, i kishte thyer, me sa dukej, edhe ato klishe. Dashurimi, në qoftë se do të ngulej këmbë për gjetjen e gjurmëve të tij, shfaqej në atë fytyrë nëpërmjet ftohtësisë. Ishte një ftohje sipërane, me një lënim mermeri të plasaritur te mollëzat dhe me një krisje te sytë. Ishte një krisje si prej qelqi, pas së cilës drita verbuese, e burgosur në kafkën e tij, jepte herë pas here përndritje gjithë rrezik.

— Faleminderit për këtë vizitë, — tha ai, pa lëvizur nga nimi.

Pas shpatullave të tij ishte dritarja dhe në të dukeshin degët e mollëve. Isha gjithë kujdes që të mos thosha ndonjë gjë të pamenduar, ngaqë kisha ndjesinë se ndodhesha në një botë kristallore, ku një lëvizje e pakujdesshme mund të thyente gjithçka. Po aq më tepër kisha frikë nga një

bisedë rutinë: si keni qenë me shëndet etj.

— Duhet t'ju falenderoj unë që më pritët, — thashë, duke u matur, që në mënyrë sa më të përkorë t'i thosha diçka për gëzimin që na shkaktonte të gjithëve, duke qenë gjallë, midis nesh, si stolia më e çmuar...

Kishte qenë përherë aq i vështirë fillimi i kuvendimit me të. Ndryshe nga hera e fundit, kur më ishte dashur të kisha kujdes si për flakëzën e një qiriri që mund të fikej lehtë, tani ishte e kundërta: duhej të ruaja ngrirjen e tij olimpike prej squlljes së rëndomtë.

Si t'ia thosha se, ndonëse librat e tij ishin si përherë të ndaluar, se ndonëse ai vetë, qysh nga ajo mbledhja e mjerë mungonte gjithkund, mendja e njerëzve gjithmonë e më shpesh kthehej tek ai. Prej tri-katër frazave, që fillonin të gjitha me një *ndonëse*, po përpiqesha të zgjidhja një të, atë më të përshtatshmen, kur ai, si ta gjente ç'kisha në mendje, ma ndërpreu torturën:

— Kombin e bëjnë poetët, kjo dihet. Ata, qeveritarët, — ai bëri me dorë në një drejtim, si të tregonte këndin ku gjendeshin, — kur bëjnë ndonjë punë, ndonëse bëjnë sikur na kanë harruar, te ne e kanë mendjen: Ç'do të thotë Lasgushi për këtë? Ç'do të thonë poetët?

— Është krejt ashtu, — i thashë.

Një copë herë ai tundi kokën duke vështuar duart e tij. Buzëqeshja e akullt mezi e ndiqte kokën në lëvizjen e saj, kështu që herë-herë mbetej si e varur në hapësirë.

— Bëjnë sikur na kanë harruar, po mendjen e kanë te ne, — përsëriti ngadalë. — Që nga ai, kryetari i tyre... Me që ra fjala, ç'bën ai, gjallë është apo ka vdekur?

Mbeta i mahnitur nga këto fjalë. Të bëje këtë pyetje për udhëheqësin e vendit, për atë, portretet e të cilit

mbushnin muret, tregtizat, libraritë të shoqëruara nga fjalët *rroftë, rroftë, rroftë*, ishte më tepër se habi. Dhe pyetjen e bënte pikërisht poeti i harruar, ai për të cilin zyrtarët e të gjitha shkallëve, duke përfshirë me siguri edhe vetë udhëheqësin, me ligësi, smirë dhe padije kishin ëndje të thoshin: ç'bën vallë, rron apo ka vdekur?

Ishte dhjetë vjet më i moshuar se udhëheqësi, megjithatë i qe dukur e natyrshme ta bënte atë pyetje. Më tepër se hakmarrje vetjake, ishte shpërfillje.

Bud poljégçe s poetom, sùdar! Ji i butë, sundues, me poetin!

Ky varg, që nuk më kujtohej i kujt ishte, më erdhi befaz në kujtesë, me po atë tingullsi me të cilin lëshohet thirrja paralajmëruese: kujdes! Veç ajo thirrje nuk i drejtohej bashkëbiseduesit tim, por atij, *tjetrit*.

Ishte treguar i egër me poetin. Madje edhe më keq: pa guxuar t'ia bënte të keqen haptaz, ia kishte bërë atë tërthorazi, me ligësi meskine, siç janë shpesh hakmarrjet e nxitura nga smira.

Pas supeve të tij degët e mollëve lëkundeshin qetë. Në një ditë tjetër do të përpiqesha ta sillja bisedën për dashurinë, gjë që nuk ishte e vështirë me të. Por, pas asaj që tha, nuk mundja. Në një ditë tjetër, i shqetësuar nga ajo që ai s'po e përmendte dashurinë, do të dyshoja se e kishte harruar ndërkaq historinë e tij me Ana G., se kishte hequr dorë prej aventurës, marrëzisë madhështore dhe unë do të kisha qenë gati t'i bija në gjunjë, duke iu lutur në emër të të gjithëve që të mos e linte pa përmbushur atë mision. Mjeshtër, kalorës i përjetshëm, bëjeni, për ne të gjithë, për ... *e në dashunës botës sanë*. Në një ditë tjetër ndoshta do t'ia thosha këto, por atë paradite kur ai bëri

pyetjen madhështore, gjithçka tjetër u zbeh përpara saj. Një hidhërim i brendshëm ia bënte edhe më të kthjellët shikimin.

— Te Homeri është një vend ku dielli zemërohet me Zeusin, nuk e di a të kujtohet, — tha pas pak. — Kështu pra, dielli zemërohet me tiranin dhe e di si e kërcënon? *Në Ferr do zbres, do shndrit veç për të vdekurit!* — Ai buzëqeshi më ftohtë se më parë. — Ja, pra, ç'kërcënim të gjëmshëm i bëri tiranit dielli. Të lerë vendin e vet në mes të qiellit, me fjalë të tjera të braktisë të gjallët dhe të zbresë atje ku s'ka nevojë për të, tek të vdekurit. Shkurt, çdo gjë të bëhet së prapthi, me fjalë të tjera, të vijë fundi i botës, apokalipsi... Të tillë kërcënim të tmerrshëm dhe jo naze zonjushash duhet të bëjë poeti.

Ai nuk m'i hiqte sytë e tij të akullt, me plasaritjet e pamëshirshme midis, kërcënues dhe i pashmangshëm, si një ajsberg. Një copë herë të gjatë qëndruam kështu në heshtje, pastaj ai shtoi: - Me sa kam lexuar prej teje, ti gjithashtu ke filluar të zbresësh tek të vdekurit...

Mora frymë i lehtësuar, si të kisha dëgjuar një dekret faljeje.

Pasditja ishte e hirtë, kufkë, por ndoshta pikërisht ngaqë ishte e tillë unë nuk e kisha vështirë ta mbushja atë me gjithfarë përfytyrimesh. Pasi u enda te plepat e hotelit të vjetër dhe te oborri i manastirit të braktisur, qëndrova një kohë të gjatë ndanë plazhit, sipër të cilit zogjtë, të vetmet gjëra që nguteshin në këtë qytet, vërtiteshin me klithma të paqeta. Pastaj, ngadalshëm, i rashë kryq e tërthor rrugëve, duke u përpjekur të marr me mend se në

ç'kinkaleri ndalej Ana G. për të blerë ato çka i duheshin, në kohën kur kishte filluar takimet me të...

Në sofate portash, pleq të ngjashëm me cungje ku mezi dalloheshin përzhitje rrufesh të vjetra, vështronin liqenin. Ishin shokë të tij të rinisë, të cilët ngaqë flisnin rrallë, e kishin harruar gjysmën e gjuhës dhe që fjalën *skandal* e thoshin *shkàndull*, me theksin në rrokjen e parë, si në shqipen e vjetër. Kishin thënë vallë: pu, pu, ç'na turpëroi Lasgushi apo kishte mjaftuar veç ajo fjalë, e ngjashme me një zhguall breshke, për të shprehur gjithçka që mund të mendonin ende për mjellmën e lehtë veriore, që ia kishte prishur mendjen shokut të tyre.

Këmbët më çuan prapë nga zallishtja dhe mendimi se ata të tre: qyteti i vogël klimaterik, liqeni dhe poeti kishin të njëjtin emër s'mu nda një copë herë. Vite më parë, si të mos mjaftonte grindja e njerëzve nëse liqeni ia kishte dhënë emrin qytetit apo e kundërta, kishte mbërritur poeti i ri nga studimet e Vjenës, për t'u bërë pjestar në atë emër.

Rruga Një Maj. Sheshi Fitorja e socializmit. Rruga Kajo Karafili. Shëtitorja Enver Hoxha.

Mbrëmja më zuri kështu, ndërsa përpiqesha të gjeja një rrugë të përshtatshme për emrin e tij dhe natyrisht të Ana G.

Që larg, në atë pjesë të qytetit ku qenë vilat e udhëheqësit rrezëtinin dritëzat. Kurse kulla e poetit ndodhej në drejtimin tjetër. Kishte vite që pushonin të dy në një qytet, por nuk ishin takuar kurrë. Në vilat e të parit vinin të ftuar shpesh, gjithfarë zyrtarësh e veprimtarësh të ndryshëm, veteranë, plaka, "artistë të merituar", veç ai, krenaria e poezisë shqipe, nuk kishte

marrë ftesë kurrë.

Në ndonjërin prej darkave, dikush prej të ftuarve, për ta zbavitur udhëheqësin, do të kishte përmendur ndoshta marrëzinë e fundit të poetit. Dhe tjetri do të kishte qeshur me të madhe: ha, ha, ha, gjersa e qeshura, për habinë e të gjithëve, do të zëvendësohej në sytë e tij nga një hije e zezë. Kishte kujtuar se duke e veçuar krejt, e kishte ndaluar të jetonte, kurse paskësh ndodhur e kundërta. Në një çast tjetër do të gërmushej: ç'është kjo Ana G., ç'bënin shokët e sigurimit atje në veri, ku ishin dosjet, hetimet, kontrollet në rrugë, por me sa dukej, tani ishte vonë për të gjitha. Qysh tani, ende pa ardhur ajo vetë, ndihej pesha e vdekjes. Vetëm ajo, me sa dukej, ashtu si nata yjet, mund ta nxirrte nga terri. Dashuria e fundit e poetit, kjo lule e mortjes, ishte bërë e mundur ngaqë mbrohej prej saj...

Askush prej darkëtarëve s'mund ta kuptonte brengën e udhëheqësit. I dukej se të gjallë e kishte patur nën kontroll poetin, kurse i vdekur ai do t'i shpëtonte. Por, pikërisht vdekjen s'ia pengonte dot...

Bud poljègçe s poetom, sùdar. Po në qoftë se sunduesit i thuhej: ji m'i butë me poetin, sundues! Ç' do t'i thuhej vallë poetit kur të vinte ora e gjykimit të tij? Ji m'i butë me sunduesin, poet?! Ha, ha, ha.

Vizitat e sunduesit H. në kullën time... Përderisa kjo nuk qe shkruar e s' do të shkruhej kurrë, do të thoshte se tjetri ishte i humbur.

Nuk i hiqja dot sytë nga ajo rregëtimë e largët dritëzash. Më kishin treguar se pikërisht në ato ditë, ndërsa në Tiranë vazhdonte gjyqi kundër pjesëtarëve të familjes së rivalit të tij të përmbysur, në mbrëmje i sillnin

videokasetat ku qe regjistruar gjithçka dhe ai, bashkë me gruan, fëmijët, dhëndrrin dhe nusët qeshnin e talleshin tek i shihnin të lidhur me pranga, të rrënuar në baltë, kokëqethur, ata me të cilët pak kohë më parë i kalonin pushimet së bashku.

Ishte ndoshta stina e fundit që të tre emnakët, qyteti, liqeni dhe poeti, veronin së bashku. Me mbrojtjen e liqenit do të vazhdonte të merrej UNESKO-ja. Qyteti s'dihej ç'fat do të kishte. Kurse poeti i kishte dhënë të gjitha shenjat se po bëhej gati për zhvendosje. Asgjë s'kishte qenë e rastit: as ngjyra e ftohtë, si në morg, e manikyrit në gishtat e Ana G., as brenga e udhëheqësit dhe as kërcënimi i madh.

Ishte vonë, ndoshta mesnatë, kur një nga rrugicat më nxorri në një lloj fushëtire. Ishte fresk, ndihej thellësia e qiellit dhe yjet e lartë si rrallë herë sipër tij. Në vjeshtë shtërgjet duhet të dukeshin që këtu tek niseshin për larg.

Fluturoi dhe shtërg i fundit madhështor me shpirt të gjorë.

Më erdhi të thosha: ku do të nisesh, shtërg i madh, dhe ku do të na lësh ne, të gjorëve?

Tiranë, prill - qershor 1986
Paris, maj 1998.

Le Monde

**La menace
du soleil**

par **Ismail Kadare**

UNE NOUVELLE INÉDITE

Traduit de l'albanais par Yusef Vroni

Ballina e botimit të *Kërcënimi i diellit*, Le Monde, Paris, korrik 1998

IKJA E SHTERGUT

~~KERCENIMI I DIELLIT~~

Ishte një mbasdite gri, nga ato prej të cilave s'pritën veç
përsëritura dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, ndërsa ecja
në anën tjetër të trotuarit pashë R.P.,
ku do të më mendohej. Ishte vonë për t'iu
e rrugës ishte e
e i përmall,
e i thoshja:

Prill 1986
20 qershor 1986

1

IKJA E SHTERGUT

Fluturoi dhe shtergu i fundit
L. Poradec

Gri, nga ato prej të cilave s'pr
të mos mjaftonte kjo, nd
trotuarit pash
dhe
shtërgjet duhet
ndit madhështor me shpirt të gjorë.
ne, të gjorëve?
te thoshja: ku do të nisesh shtërg
madh, dhe ku do

Tirane prill 1986
Paris maj 1986

Faksimile të dorëshkrimeve të të dy varianteve të Ikja e Shtërgut

APOTEOZA PËR POETIN OSE KUNDËRTIRANIA

Ikja e shtërgut paraqet një interes të trefishtë, sepse është një vepër *antologjike, historike dhe laboratorike*.

Në tregim ndërthuren analiza e hollë psikologjike, mendimi i thellë filozofik, thujtja e padukshëm, portretizimi skulpturor tepër i thukët, të shoqëruara këto shpeshherë me ligjërimin e ngritur në apoteozë të heroit rrëfyes, që haset rrallë në prozën e Ismail Kadaresë. Prandaj, për vlerat letrare të spikatura do të mund të hyjë në *tregimet e zgjedhur, antologjikë* të autorit.

Ikja e shtërgut është shkruar në rrethana tepër të vështira të censurës (1986), kur shkrimtari, me mendimin e lirë, rrezikonte veten dhe veprën e tij. Megjithëse është shkruar nën censurë, ka një mesazh të hapur kundërtotalitar dhe kundërtiran, duke shënuar, kështu, një fazë të veçantë në procesin e krijimit — shpërfilljen ndaj vetëcensurës. Me *Ikja e shtërgut* dhe me tituj të tjerë shfaqet një dukuri e re në krijimtarinë e Ismail Kadaresë — veprat e shkruara, por të pabotuara dhe të pabotueshme. Këto, si dhe veprat e shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, që u shkruan nën totalitarizëm dhe kundër totalitarizmit komunist, por, që dolën në dritë pas rënies së tij, zenë një kapitull më vete në historinë e letërsisë

shqipe bashkëkohore. Në këtë kuptim, *Ikja e shtërgut* është një *vepër historike*, sepse ka rëndësi si për historinë e krijimtarisë shumë të pasur të Ismail Kadaresë, ashtu edhe për historinë e letërsisë shqipe bashkëkohore.

Ikja e shtërgut, si rrallë ndonjë vepër tjetër e Ismail Kadaresë, është në dy motërzime që ndahen nga një periudhë trembëdhjetëvjeçare. Krahasimi i motërzimit të dytë (1998) me motërzimin e parë (1986) hap një portë për të hyrë në laboratorin krijues, gjigand dhe të ndërlikuar të Ismail Kadaresë, megjithëse shumë porta shkrimtari i ka hapur vetë në *Ftesë në Studio* dhe *Bisedë me Alain Bosquet*. Për këtë arsye, *Ikja e shtërgut* është një vepër *laboratorike* për studiuesin, meqë vjen bashkë me disa të dhëna e të fshehta të laboratorit krijues të shkrimtarit. Dhe, po ashtu, mund të analizohet gjatë në laboratorin e studiuesit për të hulumtuar sidomos parapëlqimet dhe mënyrën e ripunimit të veprës prej Ismail Kadaresë.

1986. Shpërfillja e vetëcensurës

Procesi i të shkruarit në diktaturë për shkrimtarin që ndjehet i lirë në vetvete është i jashtëzakonshëm, sepse është dy herë i vështirë dhe dy herë i mundimshëm. Krijimi nuk është vetëm përpjekje për të shfaqur vazhdimisht origjinalitetin dhe për të arritur përsosmërinë. Gjetja e *një marrëveshjeje me vetveten* mbi mënyrat e përshtatshme për të kapërcyer censurën është jo më pak e mundimshme, jo më pak e vështirë.

Kompromisi, i vogël apo i pjesshëm, ka qenë një

marrëveshje e njohur që ruante shkrimtarin, por asfiksonte, rrezikonte dhe tjetërsonte krijimtarinë.

Ismail Kadare, që e ndjente së largu asfiksinë dhe nuk e duronte dot, ka përdorur, zakonisht, një marrëveshje tjetër — *mashtrimin artistik*, kapërcimin e censurës nëpërmjet lojës së figurave, mbulimin e mendimit nëpërmjet stërhollimit parabolik të shprehjes. Prandaj nuk do të ishte gabim të thuhej se censura, sidoqoftë, ka ndikuar jo pak në simbolizimin e përkryer të veprës së tij. Ndërsa *Ikja e shtërgut* është nga krijimet e para të tij, ku kundërtotalitarizmi dhe kundërtirania shfaqen fare haptaz. Në këtë tregim, përgjigjet në bisedë Ismail Kadare për “Ikja e shtërgut”, *flitej fare haptas për Shqipërinë komuniste... atje gjithçka thuhet me emrin e vet.*

Heqja e pancirit historizues simbolik që kishin më parë p.sh.: *Pashallëqet e mëdha* (1978), *Pallati i Ëndrrave* (1981) etj., është një hap krijues shumë i rëndësishëm, është një ndryshin i thellë në mënyrën e krijimit, sepse përmban guximin çlirues të vetvetes prej një pushteti tepër të rëndë e ndëshkues, përmban mohimin përfundimtar të çdo lloj vetcensure. Furitë kundërtotalitare, që në brendësi të shkrimtarit kishin vluar vazhdimisht, tanimë, nuk mund të mbulohen me asnjë shprehje letrare të tërthortë. Ato e shpërthejnë *shtratin e zakonshëm* simboliko-alegorik dhe vërshojnë në një *shtrat tjetër*, mjaft të rrezikshëm, në atë të shprehjes së drejtëpërdrejtë. Kjo është një *gjendje psikologjike e re* e shkrimtarit, e, për pasojë, është dhe një *gjendje krijuese e re*, që nuk pranon asnjë lloj pushteti dhe asnjë lloj kufizimi. Shkrimtari mendon, përjeton dhe shkruan krejtësisht i lirë, sikur të jetë në një botë

tjetër, edhe pse dogma si makth dhe censura si shpatë e Damokleut sundojnë në letërsi. Kjo është, gjithashtu, edhe një mënyrë e re e të shkruarit, nëse simbolika historizuese do të merrej edhe si një trajtë e ruajtjes prej censurës. Shkrimtari, që deri tani, në një masë, ishte i mbrojtur prej ambiguitetit, këtë herë del plotësisht i zbuluar, i pambrojtur. Shprehja e drejtëpërdrejtë e veprës e nxjerr shkrimtarin në ndeshje të hapur me totalitarizmin. Për këtë ndryshim në vetëdije dhe në procesin e krijimit, meqë tejkaloi kufijtë e ringut që i kishte caktuar vetes në ndeshje me totalitarizmin, iu desh të ndryshojë hallkën e botimit. *Ikja e shtërgut* e shkruan, por, kurrësesi nuk mendon ta paraqesë për botim. Pra, bën edhe një tërheqje për t'u mbrojtur. Ai që rrallë kishte lënë ndonjë vepër pa e dorëzuar për botim, përkundrazi, shpesh herë kishte kundërshtuar me ashpërsi vërejtjet dhe vonesat, për *Ikja e shtërgut* do të presë ditën e përshtatshme, megjithëse pafundësisht. *Me sa duket, jeta dhe fytyra natyrale e një veprë*, thotë Ismail Kadare në bisedë për "*Ikja e shtërgut*", sigurohet kur vepra krijohet për t'u botuar. *Është natyrale kjo gjë, edhe kur kushtet e botës në të cilën vepra do të dalë, janë të ftohta dhe armiqësore për të. Me fjalë të tjera, e natyrshme është që vepra të dalë nga një terr që është ndërgjegjja e shkrimtarit, jo për të hyrë në një terr tjetër, në një sirtar, në një kasafortë si në sarkofag, por të dalë në botë.*

Pavarësisht nga kjo, ai më tepër dëshiron ta lërë tregimin si dëshmi të padiskutueshme për bindjet e tij. Ai që botimin e kishte mënyrë të vetme të të punuarit dhe të qenies së veprës (për këtë arsye simbolet dhe alegoritë i ka përdorur jo pak për të kapërcyer censurën) në gjendjen e re të vetëdijes,

në kulmin psikologjik të kundërtotalitarizmit, më shumë se botimin do të çmojë zbulimin e plotë të vetvetes, veprën e çliruar nga vetëcensura si edhe nga simbolika e përftuar për shkak të censurës. Atëherë ishte i bindur se komunizmi do të qëndronte ende gjatë, sikurse pohon në librin *Dialog me Alain Bosquet: Në atë kohë dhe shumë vite më pas, askush nuk mendonte se komunizmi do të binte aq papritmas. Ne ishim të bindur që do të vdisnim nën këtë regjim.*¹⁾ Prandaj *Ikja e shtërgut*, bashkë me disa vepra të tjera, do ta ruajë në Francë jo vetëm për ta shpëtuar nga ndonjë rast kontrolli, por edhe për të patur mundësi që miqtë e tij ta nxirrnin në dritë.

Në ato rrethana *Ikja e shtërgut* ishte një lloj letërsie tjetër, sikurse edhe shkrimtari ishte një tjetër dhe në një pozicion tjetër. Vepra është shkruar nën censurë, por pa vetcensurë, kurse shkrimtari në vetvete ishte i çliruar plotësisht. Atë e ka krijuar çlirimi i brendshëm i shkrimtarit. Kjo është edhe përgjigjja e pyetjes: *Pse çmohet kaq Ikja e shtërgut edhe në procesin e krijimit?*

Ismail Kadare deri në mesin e viteve '80 kundërtotalitarizmin e kishte mishëruar në disa kryevepra të botuara, veçse nëpërmjet simbolikës historike dhe alegorisë. Atëherë, përse e kishte të domosdoshme ta shpallte haptas, për më keq, kur rrezikonte mjaft veten dhe veprën?

Gjuha simboliko-alegorike mundet të jetë e vetme dhe e përjetshme për shkrimtarin. Censura, gjithsesi, është shkak i dytë për të, pasi ajo më shpesh parapëlqehet për shumëkuptimësinë, natyrën tepër

1) Ismail Kadare: *Dialog me Alain Bosquet*, Onufri, Tiranë 1996, faqe 42

intriguese, sintezat e fuqishme etj. Me gjuhën simboliko-alegorike shkrimtari fare mirë mund të vetëshprehet deri në fund e të *çlirohet* plotësisht prej makthit dhe vuajtjeve të brendshme të krijimit. Jo pak shkrimtarë të mëdhenj, veçanërisht të shekullit tonë, nuk e kanë patur aspak të nevojshme të shprehen në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përkundrazi, i janë shmangur asaj për të rritur fuqinë intriguese dhe sintetizuese të artit, natyrisht, pa patur asnjë trysni censure politike. Mirëpo trysnitë, psikologjiksht, linden gjithmonë kundërveprimin, dëshirën deri në obsesion për të kundërtën. Shkrimtari i lirë pa *censurën politike* priret të krijojë *censurën artistike* sa më torturuese, sa më të vështirë të metaforave, simbolikës dhe alegorisë, ndërsa shkrimtari nën *censurën politike* vuan e përgjërohet që të flasë pa metaforat dhe simbolet mbrojtëse prej censurës. Është një proces i thellë psikologjik që sjell ndryshime, çarje, zhvendosje, përmbysje, dyluftime, veçime në marrëdhëniet *shkrimtar-njeri*, sikurse edhe në trajtat e përfutimit të letërsisë. Deri atëherë (1986) shkrimtari kishte arritur ta mbronte njeriun Kadare, pikërisht, me gjuhën simbolike të veprës. Shkrimtari, në tërë këto vite, vërtet e ka mbrojtur njeriun, por edhe e ka *tejdisiplinuar, nënshtruar*, pse jo, deri diku, edhe e ka *tjetërsuar*.

Tjetërsim është, bie fjala, simbolika për shkak të censurës politike, ndalimi, fshehja e shumë mendimeve që vlojnë në brendësi të tij etj. Mirëpo, vjen një çast kulmor psikologjik dhe shpirtëror, kur njeriu i privuar, i nënshtruar, i rrezikuar të tjetërsohet prej trysnisë dhe për hir të shkrimtarit të mos përmbahet, të ngrejë krye, të dalë mbi shkrimtarin për ta shprehur dhe çliruar plotësisht njeriun. Në një rast

të tillë, mundet që njeriu të fitojë së bashku me shkrimtarin, por mundet që të humbasin edhe të dy, për shkak të rebelimit të njeriut.

Në këtë tregim, njeriu i rebeluar Kadare fitoi lirinë, u çlirua plotësisht në vetvete, sepse u vetëshpreh haptas, duke shpërfillur vetëcensurën simboliko-alegorike që kishte përpunuar *djalli* i shkrimtarit. Natyrisht, u çlirua edhe shkrimtari përderisa gjithçka thuhet me emrin e vet. Me këtë *çlirim* nis edhe rruga e largimit të tyre prej Shqipërisë totalitare, për t'u strehuar politikisht në Perëndimin pa censurë. Ata e kanë marrë strehimin e parë politik në Francë qëkur u mbyll në kasafortë *Ikja e shtërgut* dhe vepra të tjera.

1998. Riti i përkryerjes

Ismail Kadare vazhdimisht i përpunon dhe i ripunon veprat. Kjo është shenjë e aftësisë së madhe krijuese dhe e mendimit të tij përherë në zhvillim, siç është edhe shenjë e vetëdijes së pakënaqësisë së përhershme dhe e kërkimit të përsosmërisë. Përpunimi është thjesht mënyrë e të shkruarit, është zakoni i tij, madje i kthyer në rit, meqë përherë do të ndreqë, plotësojë a përmirësojë diçka. *Dhe dihet*, thekson ai në bisedën e tij, *që bukuria, përkryerja artistike e një veprë bëjnë pjesë në lirinë e saj*. Kjo mënyrë të shkruarit përsëritet e ripërsëritet në çdo veprë, në mënyrë që ato të kenë sa më tepër liri, të jenë sa më të përkryera. Në këtë rast, shkrimtari ngjan me atë Bukuroshen që, edhe pse e ka fituar kurorën e artë, prova më bindëse e hijeshisë absolute të saj, vazhdon të rrijë para pasqyrës se mos i

shfaqet ndonjë shformim që mund ta kapë vetëm syri i saj ose rri në pritje të ndonjë njolle hënore që as vetë nuk beson se mund t'i shfaqet.

Ikja e shtërgut, natyrisht, kishte më tepër arsye për t'u riparë, pasi ishte shkruar në një *gjendje psikologjike krejtësisht të veçantë*, pa asnjë lloj vetëcensure, e kështu, hamendësohet të jetë shkruar me një frymë, me ngut, siç shkruhen veprat e përjetimeve të thella e të gjata që mbartin një peng të madh, të vjetër të shkrimtarit. Autori, duke dashur të lerë një dëshmi krijuese të çlirimit të plotë prej vetëcensurës, kishte mundësi të *harronte* përsosmërinë artistike. Por, si çdo vepër e vetvetishme, asaj nuk i mungoi cilësia artistike kadareane. Nëse ishte arritur cilësia, përse u ripunua, madje jo pak, por, ndër të tjera, duke shtuar disa faqe, konkretisht, skenën e rishfaqjes së Lasgushit në mbledhjen e shkrimtarëve dhe skenën imaginative të mbikqyrjes policore të heroit rrëfyes?

Elipsa, mungesa e disa të dhënave mbi realitetin totalitar, që, megjithatë nënkuptoheshin, përbënte një forcë të madhe sintetizuese në motërzimin e parë. Në motërzimin e dytë theksimi i frikës, i ankthit, për të mos thënë theksimi i obsesionit prej mbikqyrjes e ndëshkimit, është një përbërës i thellë i psikologjisë së njeriut në totalitarizëm, që doemos, e pasuron tregimin.

Cili motërzim është më i arrirë?

Është e vështirë të përcaktohet, por edhe pa dobi. Të dy motërzimet përbëjnë një vepër. Qenia në dy trajta e të njëjtës vepër i lejon studiuesit të shohë procesin e ripunimit kadarean, parapëlqimet ripunuese të tij. Kështu, personazhet skajohen edhe më tej në tiparet e tyre. Te heroit rrëfyes theksohet

edhe më mërzia e pashpresë, e shkaktuar prej kotësisë dhe monotonisë së jetës, mendimet brutale të pashfaqura si shenjë e rebelimit të brendshëm të tij, ekzaltimi përgjërues për Lasgushin, kurse te personazhi i mërzitshëm P.T. (motërzimi i dytë R. P.) — një lloj Uriah Hipi — përforcohet bezdia tmerruese që ngjall te të tjerët. Po ashtu, rrëfimi dhe përshkrimi pasurohen me lëndë të re që fuqizon kundërshtinë Tiran-Poet, epërsinë e Poetit mbi harrimin dhe vdekjen, thellësinë psikologjike — mungesat që janë shkak i gjestit dashuror të Lasgushit etj.

Shkurt, ripunimi kap më tepër anët thelbësore. E tillë thelbësore është edhe përkujdesja e madhe gjuhësore. Saktësimi edhe i hollësive, konciziteti, zëvendësimi deri në fund i fjalës së huaj me fjalën shqipe janë përbërës kryesorë të ripunimit, pra, të përkryerjes së veprës së tij.

Lasgushi/Poeti

Ikja e shtërgut merr shkas nga një ndodhi dashurore në jetën e Lasgush Poradecit²⁾, kur ai ishte në moshë të thyer tetëdhjetëvjeçare. Portreti që është gdhendur: me cilësitë psikologjike, me tiparet e fytyrës dhe me gjestet, me mënyrën e të folurit, të sjellurit, me veshjen e tij etj., është, gjithashtu, shëmbëlltyra e njëmendtë e tij. Megjithatë, do të ishte thjeshtëzim nëse do të kuptohej si një tregim për të, qoftë edhe për *marrëzinë* e dashurisë. Përkundrazi.

2) Ismail Kadare: *Ftesë në studio*, Naim Frashëri, Tiranë 1990, faqe 222

Duke qenë i frymëzuar prej tij dhe kushtuar atij (prandaj mbart tiparet dhe bëmat e njëmendëta të Lasgush Poradecit) është, para së gjithash, një tregim për Poetin në rrethanat e totalitarizmit dhe të despotizmit komunist, është tregim për qënien poetike universale mjaft të ndërlikuar. Poeti, tradicionalisht, së paku deri në fillim të shekullit XX, shihej mjaft i ndërlikuar, veçanërisht ngaqë përfytyrohej i mistifikuar. I mistifikuar prej të tjerëve, por edhe i vetëmistifikuar; i vetëvlerësuar drejtë, por dhe i vetëmbivlerësuar qëllimisht; i idealizuar prej të tjerëve, por edhe i vetidealizuar; gjithmonë i lënduar prej të tjerëve, por edhe i lënduar prej mbindjeshmërisë së tij; i nënvleftësuar dhe i mënjanuar prej një kundërshtari të madh, posaçërisht prej sundimtarit tiran si dhe mediokërve, por edhe i vetëmënjanuar si dëshmi e epërsisë së vetëdijshme ndaj tyre. Për fat dhe, çuditërisht, te Lasgush Poradeci harmonizoheshin në mënyrë të përkryer tiparet e tij vetjake me tiparet e qënies poetike universale, për të mos thënë se ai më tepër ishte poet, qenie poetike. Ishte lindur dhe u formua i tillë, por shpesh u vetëteatralizua si i tillë.

Njeriu tek ai ishte Llazar Gusho. Në rininë e tij të hershme e hoqi emrin e pagëzimit për t'u humbur dhe për t'u harruar njeriu, për ta hequr njeriun prej vetes si lëvozhgën a ngarkesën e tepërt, për ta hequr, pikërisht, atë qenie të zakonshme, të rëndomtë, pse jo edhe penguese, që kishte patur përderisa nuk ishte bërë poet.

Kur u vetëquajt Lasgush Poradeci, në të vërtetë, u pagëzua poeti. Përgjatë shtatëdhjetë vjetësh, në kalvarin e krijimit gjithnjë e më shumë u largua prej Lllazarit, prandaj gjithnjë e më shumë u harrua

njeriu, për të mbetur përherë e më tepër Lasgushi, poeti, qenia poetike. Humbja e njeriut, Llazarit, madhësonte poetin, Lasgush Poradecin. Llazari ishte lindur për t'u shndërruar në Lasgush Poradeci. Por, ai edhe vetëdijshëm e shndërroi veten në qenie poetike universale. Kur Llazari ndërroi jetë, pra, kur u shformua fizikisht ajo që kishte mbetur prej njeriut — lënda, trupi — Lasgushi vazhdoi jetën, sepse poeti është i pavdekshëm. Ai e kishte nisur përjetësinë që në gjallje të Llazarit.

Ikja e shtërgut është tregim për qenien poetike të gjithëkohëshme, për Poetin, për Lasgushin dhe jo thjesht për Llazar Gushon. Në tregim, kryesisht, lexohet Lasgushi personazh — përgjithësim i Poetit.

Mungesa për ligj dashurinë

Lasgushi dashuron në moshën tetëdhjetëvjeçare! Një dashuri e tillë, në rëndomësinë e jetës, është e jashtëzakonshme. Lasgushi përsëdyt, kështu, në historinë e letërsisë, një shekull e gjysëm më pas, dashurinë e Gëtes në pleqërinë e thellë të tij. Është një idil lumturues, dhuratë e rrallë, ndofta, vetëm për poetët filozofë me mbindjeshmëri, që edhe u shfaqet, edhe e kërkojnë, edhe e përballojnë me potencialin e madh shpirtëror. Ndofta, është dhurata mirënjohëse ndaj artit që kanë krijuar, ndaj privimeve të panumërta që mundet të kenë patur për hir të tij. Këta vetëmohues të mëdhenj, në emër të dashurisë njerëzore e meritojnë të largohen nga jeta përmes aktesh të tilla dashurore emocionuese.

Aventura apo marrëzia madhështore e Lasgushit nuk përdoret për të shkruar një tregim tërheqës për

të fshehtën e një dashurie të tillë, pasi kjo është jashtë stilit të Kadaresë. Me joshjen erotike përmbi, ajo rrëfëhet si një ndodhi që zbulon në thellësitë psikologjike e shpirtërore burimin e Erosit. Është një dukuri tepër karakterizuese, tepër domethënëse, është një *shenjë qiellore* që shfaqet, bie fjala, në njëqind-njëqind e pesëdhjetë vjet, gjurmët atmosferë-ndryshuese të së cilës mbeten deri në rishfaqjen e saj. Dashuria e pleqërisë nuk është thjesht fryt i pastër i shpirtit dhe i tërheqjes trupore, por, më tepër, është një gjendje e jashtëzakonshme, e papritur, jo dhe aq e ndërgegjshme, jo dhe aq kënaqësidhënëse, është një shfryrje psikologjiko-shpirtërore, një kundërveprim vetjak ndaj ndalesave dhe trysnive shoqërore të mëparshme. E është, pra, një *lirim i shkurtër pas një traume të gjatë*.

Meqënëse jeta e Poetit, edhe në *Ikja e shtërgut*, është një *traumë* e vërtetë e totalitarizmit, për ta kuptuar tregimin, mbase, do të ndihmonin konceptet dhe qasja frojdiste. Dashuria e pleqërisë është një plotësim i brendshëm i mungesave të mëdha të Poetit në kohën dhe në hapësirën totalitare, është një *transferim* (term i Frojdit)³⁾, domethënë një *shpalosje afektuoze* e dashurive dhe e kënaqësive të munguara të Poetit. Dhe, gjithashtu, është një *zhvendosje* e kënaqësive nga bota e tij e brendshme, intime që ka qenë e ndrydhur, e censuruar në botën e jashtme, në jetën shoqërore të përgjithshme. *Zhvendosja*, natyrisht, është e *sublimuar*, e shndërruar në kënaqësi, në afekte për të tjerët. Edhe kjo, tek e fundit, është një dashuri për shkak të mungesës, siç

3) Zigmund Frojd: *Pesë leksione për psikoanalizën*, Fan Noli, Tiranë 1997, faqe 64

ndodh në çdo dashuri. Mungesat e përligjin këtë dashuri, edhe pse në dukje është paradoksale dhe e papranueshme.

Që në lashtësi dhe deri në kohët moderne, dashuria për filozofët dhe psikologët ka qenë konceptuar si dëshirë, kërkesë, nevojë e njeriut për atë që i mungon, për atë që është e domosdoshme, pa të cilën nuk jeton dot dhe për të cilën braktis e harron gjithçka. Prandaj për të njeriu mund të bëjë mrekullira, sikurse mund të bëjë edhe marrëzira. Erosi i mitologjisë ishte bir i Penias, i hyjneshës që personifikonte varfërinë/mungesën. Prejardhja e Erosit prej varfërisë/mungesës, në shekuj, i ka kujtuar njerëzimit shkakun e vërtetë të dashurisë. Sokrati (470-399 p.e.r.) thoshte se *objekt i dashurisë, për atë që e ndjen, është diçka që nuk e ka në përdorim, nuk e ka të pranishme, shkurt, është diçka që nuk e zotëron, që nuk e ka në veten e tij.*

Julia Kristeva, semiologjiste dhe psikoanaliste, interprete e koncepteve filozofike dhe psikologjike për dashurinë, si dhe interprete e trajtimeve të dashurisë në kryeveprat e letërsisë botërore në librin *Histori të dashurisë* pohon: *ne dashurojmë atë që nuk e kemi: objekti i dashurisë është objekti mungues. Por, cili është ky objekt? Është e bukura ose, më mirë, aftësia për të krijuar sipas së bukurës. Dashuria është një daimon (demon) krijues, dhe për këtë, filozofi, në mungesë dhe në kërkim të së bukurës dhe të veprës, është një i dashuruar aq sa është dhe krijues.⁴⁾*

Lasgushi është pusi i gërryer nga mungesat e shumëanshme vetjake. Këto janë mungesa në

4) Julia Kristeva: *Histoires d'amour*, Editions Denoël 1996, faqe 94-95

nderimin dhe vlerësimin e Poetit, mungesa e tij në tribunën zyrtare të letërsisë shqipe, mungesa e shprehjes publike të tij, pra, në radhë të parë, mungesa shpirtërore dhe intelektuale. *Prej vitesh ishte dhe s'ishte. E kishin mënjëuar, mungonte në të gjitha ceremonitë... Qe braktisur diçka që s'duhej braktisur. Qe shkëlur me këmbë ëndrra. Nga sallat tona të mbledhjeve të ndiçuara brutalisht dukej sikur ai, munguesi i madh, kishte marrë prarimin e përkorë të llampadarëve të vjetër... Qe larguar tashmë. S'e kthenim dot nga udha... E dinim të gjithë se ishte e pashmangshme, se ai s'kishte vend në këtë kohë.*

Mungesat ekonomike nuk janë më pak dramatike për të. Në motërzimin e dytë të tregimit përdoren disa detaje rrëqethëse të varfërisë ekonomike që, mund të jenë një shkakësim i përforcuar për *marrëzinë* e tij. *Me një kostum të zi të modës së vjetër, me borsalinë me strehë të gjerë të viteve tridhjetë, dukej sikur kishte dalë nga arkivoli... Ky ishte kostumi i zi i ceremonive të vjetra.*

Për të gjitha këto ai epitotohet *munguesi i madh*. Poeti është munguesi i madh jo vetëm sepse nuk ishte i pranishëm atje ku meritonte të ishte, por edhe se ka mungesa të mëdha në vetvete: mendime, dëshira, pasione, të drejta, etj. të parealizuara. Kadare, një vit më parë, e kishte epitetuar Eskilin - *humbës i madh*, pasi atij i humbi shumica e kryeveprave, por që lavdia nëpër shekuj, megjithatë, nuk iu cënua aspak, përkundrazi, i mbeti po aq e madhe. Me sa duket, Ismail Kadarenë më 1985-1986 e ka shqetësuar mjaft *humbja* (*Eskili, ky humbës i madh* është shkruar më 1985) dhe *mungesa*. Shqetësimi, doemos, vinte edhe nga vetëdijësimi gjithnjë e më i madh për rrezikun e *humbjeve* dhe të *mungesave*, dy

vetvetja, që nëpërmjet strukjes të përftonte kënaqësitë që i kishte refuzuar jeta⁵⁾. Shfaqja e një dashurie në tetëdhjetë vjeç, psikologjikisht, është kundërpërgjigje, është një lloj plotësimi i atyre kënaqësive që jeta nuk ia kishte plotësuar, që ia kishte refuzuar. *Ai që... quhej i vdekur kishte bërë befaz diçka të jashtëzakonshme, një veprim të gjallë, në raport me të cilin ne të gjithë ngjanim si të vdekur... Ishte një revansh kundër harresës së tij?* — thuhet në tregim nëpërmjet nje pyetje retorike. Kjo lloj dashurie ishte, pra, edhe kundër mungesave, edhe kundër harresës së tij, por, mbi të gjitha, ishte *revansh* për Poetin në përgjithësi, kundër mungesave dhe harresës së Poetit në përgjithësi, *kundër poshtërimit të tij, marrjes nëpër këmbë, fyerjeve, kinezërive, dënimeve, autokritikave poshtëruese, dërgimit për riedukim në bazë, në punë prodhuese, kanale*. Ishte, pra, kundër tërë procesit barazues, nënvleftësues, tjetërsues të shkrimtarit në totalitarizëm; ishte kundër vendndodhjes së shkrimtarit në diktaturë që zhvishej prej cilësive të tij, që më tepër ndëshkohej se sa çmohej.

Llazar Gusho ishte mënjanuar, braktisur dhe harruar jo aq si njeri dhe poet konkret, por më shumë si Poet i vërtetë, i një kohe tjetër, i lirë, sipëran mbi sistemin dhe tiranin. Prandaj dhe Kadare e sublimon kundërveprimin e Llazar Gushos, e paraqet si kundërveprim të poetit sipëran, si shpagim të tij mbi botën e ndalesave, si një lloj plotësimi i mungesave të poetit në përgjithësi. Në këtë mënyrë, gjesti i tij dashuror, duke qenë akti gjallërues vetjak është edhe akti i mbijetesës, akti i epërsisë së Poetit mbi

5) Zigmund Frojd: *Pesë leksione për psikoanalizën*, Fan Noli, Tiranë 1997, faqe 61

mungesat e tij dhe tiraninë.

Lasgushi, nga ana tjetër, jeton në botën e mungesave të gjithanëshme shoqërore. Në qytetin e vogël të Pogradecit, ndërtesa e madhe e komitetit të Partisë, simbol i mbikqyrjes dhe i mungesës së plotë të lirisë, gjithçka e ka kthyer në shkretëtirë, në një sahara shoqërore. Jeta është krejt monotone, domethënë pa lëvizje, pa gjallëri e ndryshim; njerëzit janë në fikje e sipër, me sy të topitur dhe tepër të bezdishëm, truri i tyre është i molisur, ndërkohë që, qytetet janë të damblllosur, sallat e mbledhjeve të mërzitshme, plenumet me fjalë të zhveshura, ditët të hirta, të pashpresa, bosh, të vdekura, deri te plazhi i shkretuar etj. Dhe, përmbi këto, në atmosferë është mjegulla e dendur e amullisë zyrtare, kurse poshtë, këneta e përditshme.

Mungesat ekonomike janë një vuajtje e përgjithshme shoqërore dhe e pashpresë. Premtohet dhe kërkohet me rropatje, por asgjë nuk gjendet: as naftë, as rezerva kromi, as kredi nga Gjermania Perëndimore, as ari i mbajtur prej Anglisë. Përkundër këtyre, plenumet janë të shumtë dhe të pafundmë, e bashkë me ta, parullat që shtohen çdo vit. Në detin gllabërues të këtyre mungesave dhe shtrëngesave shoqërore (plenumet, parullat) qe zbuluar vetëm një thesar (dashuria), por atë s'e dinte askush. Nga mungesat, shtrëngesat dhe varfëria, kalohet në pasuri, madje në thesar. Ky thesar ndjenjësor e moral — dashuria, është plotësim i mungesave ndjenjësore dhe morale të shoqërisë, është pasuri që e shpërndan Poeti në botën e shkretuar për ta shkëputur prej eunukitetit njerëzor dhe artistik, pse jo dhe erotik. Ky thesar që shpërndahet prej Poetit është, gjithashtu, një plotësim i kënaqësive të refuzuara, të paplotësuar

të krejt shoqërisë në totalitarizëm. Është një *plotësim shoqëror*, por edhe një *shpagim i shoqërizuar*. Apo ishte më tepër një *revansh kundër kënetës së përditshme, mërzisë së mbledhjeve, rregullave të realizmit socialist, romaneve skematikë, plenumeve të pafundmë...?* — vazhdon pyetja retorike e heroit rrëfyes. E shprehur haptas, kjo lloj dashurie më tepër ishte kundër kënetës së përditshme të shoqërisë, kënetës shoqërore dhe letrare.

Me gjestin kryengritës, provokues dhe sfidues Poeti që ripohon dhe përtërin vetveten, ripohon dhe përtërin dhe të tjerët, që ende gjallojnë, ende aspirojnë, ende dëshirojnë. Ai u ringjall ndjenjat dhe i rikthen në botën e magjishme të ndjenjave. Gjesti i tij *kavaleresk jashtë kohe, i dënueshëm prej komiteeve të partisë së rretheve, prej plenumeve, kongreseve, doktrinës krijon klimë njerëzore tjetër. I zgjon ata prej letargjisë. Ata janë në gjendjen e zgjimit prej këmbanave rilindëse.*

I përsëritja dhe i përsëritja papushim ato fjalë (histori dashurie) që ishin si të mbëshjella me një kumbim të harruar këmbanash. Heroi rrëfimtari tjetërsohet në çast dhe, bashkë me të, tjetërsohen subjektivisht, për shkak të ndjenjave të tij, mjedisi dhe moti. *Kur dola nga kafeja, mbasditja dimërore, qielli, rruga, unë vetë ishim tjetër gjë.* Ai është në ekstazë prej verës lasgushiane. Ai është i *dehur*, domethënë me mendje të turbulluar dhe në gjendje kënaqësie të madhe shpirtërore. Ai është i *çakërditur*, domethënë i prishur nga mendja, që s'di nga t'ia mbajë. Por, ai është në ekstazë nga vera erotike lasgushiane, prandaj mund të thuhet se është në *ekstazë erotike*. Madje mbi të ka vërshuar, atë e ka *kapulluar vala e përndezyes*. Fjala *përndezye* shenjon

jo vetëm flakën e brendëshme që ka shpërthyer te heroi rrëfyes, por shenjon edhe fillimin e *gjendjes erotike seksuale*.

Dashuria e Lasgushit në moshë të madhe, realisht, mbase ka qenë e rëndomtë, e venitur si drita dhe e fashitur si nxehtësia e diellit në perëndimin e fundit. Por, dashuria e tij, sido që të ketë qenë realisht, është, pra, shkak që Kadareja të kundërshtojë botën e mungesave — totalitarizmin dhe, të pohojë mbijetesën e njeriut, sidomos mbijetesën e ndjenjave të tij, të parat që shteren dhe humbasin.

Mungesa e madhe e Poetit midis njerëzve dhe përmbi njerëzit, përmbi kohën dhe hapësirën, mungesa e tij e gjatë, e papërligjur, e detyruar prej zyrtarizmit sikur rrezikonte qënien ndjenjësore të etnitetit shoqëror, prandaj për rregullsi të barazpeshimeve të jetës do të plotësohet, pikërisht, me një rikthim bubullues për ta mbushur *vakumin*. *Rikthimi i mungesit të madh*, tanimë, nuk është me flatrat e poezisë, pasi ato dukej se ishin të palëvizshme nga ndryshku i dogmës shumëvjeçare, por me flatrat e dashurisë, meqë dashuria është, po ashtu, përtëritje-ndjenjash, e shpeshherë, edhe zanafillë e poezisë.

Poetët e kanë përtërirë botën me poezi, sikurse e kanë përtërirë dhe emancipuar jo rrallë edhe me dashuritë e tyre të fuqishme, herë naive e platonike, herë aventuroze e të papranueshme, herë fare të marrosura. *Këta aventurierë të psikizmit që quhen shkrimtarë*, vë në dukje Julia Kristeva, *shkojnë në fund të natës, ku dashuritë tona nuk guxojnë të rrezikohen*⁶⁾. E tillë është dhe dashuria lasgushiane.

6) Julia Kristeva: *Histoires d'amour*, Editions Denoël, 1996, faqe 461

Kështu, *munguesi i madh* shndërrohet në *rikthyes* dhe *i pranishëm i madh*; i mënjauari, i braktisuri, i harruari, i vdekuri për së gjalli shndërrohet në *gjallërues* dhe *përtëritës i madh*.

Koordinatat e qënies së Poetit

Pavarësisht nga *Erosi i marrosur* tepër intrigues, *Ikja e shtërgut* është një tregim për Poetin dhe koordinatat e qënies së tij. Këto koordinata përftohen nga këmbimi i kundërshtive të skajshme. Në fushën e gjerë semantike dallohen tri kundërshti të mëdha:

1. Vdekje — Poezi
2. Harrim — Dashuri
3. Tiran — Poet

Përjetësia është kordinata kryesore e qënies së Poetit, të cilën e fiton kur ngadhënjen me veprën e tij mbi vdekjen. Atëherë ai qëndron mbi kohën, prandaj edhe mbi vdekjen.

1. Portreti në Përjetësi

Në tregim është *Lasgushi i përjetësuar* në të ardhmen, por, që është shfaqur i tillë qysh në të tanishmen, në kuptimin e kohës së rrëfimit. Përveç fjalëve dhe shprehjeve epitetizuese të përdorura, sikundër janë *kalorës i përjetshëm*, *i trajtuar nga një skalitës që punonte për përjetësinë* etj., ai është i vendosur në *përmasën e pafund të përjetësisë* dhe,

po ashtu, portretizohet *i përjetësuar*.

Ai jeton me një kohë të veçantë, të vetën, ndryshe nga koha e rëndomtë dhe jashtë saj, në një mbikohë, që mund të quhet koha e Poetit ose e Lasgushit. *Një kohë e papërcaktuar lehtësisht (as kohë e mbretërisë, as e republikës, as e paraçlirimit) jo, një kohë tjetër, që mund të ishte brenda të triave e mund të mos ishte askund*. Një kohë që përfshin ose kryqëzon tri përmasa, zakonisht, përbën atë që quhet *përjetësi*, një kohë që është brenda të triave, e po ashtu mund të mos jetë askund, është diçka kozmike, e përherëshme, absolute, gjithsesi një formë e përjetësisë.

Me logjikën e vet të veçantë ai flet e gjykon sipas një kalendari tjetër, sipas kalendarit të përjetësisë. Prandaj nuk flet për njerëzit e gjallë, por për trupat qiellorë (diell), për personazhe mitologjikë (Zeus) dhe personazhe historikë (Homer); nuk përmend toponime të njëmendëta, por toponime të përtejbotës (ferr, botë e vdekjes); në mendjen e tij ecejaket e përditshme janë zëvendësuar me kalimet midis dy botëve — botës së të gjallëve dhe botës së atyre të vdekurve që kanë mbetur në histori. Vetë Poeti është ndërmjetësues, ndërlidhës midis tyre. Ai, bie fjala, është ende i gjallë, por në tregim përshkruhet arkivoli i tij — mjeti i udhëtimit për në botën tjetër, përmendet sarkofagu i tij madhështor. Arkivoli i tij është *prej bronzi dhe prej ari*, prej metaleve më të qëndrueshëm dhe më të çmueshëm, të padëmtueshëm prej gërryerjeve të kohës.

Lasgushi nuk ka një fytyrë njerëzore të gjallë, por një portret skulpturor të gdhendur. Portreti i tij është skalitur me fjalën *mermer*, dhe dihet që *mermeri* është lënda e busteve dhe e monumenteve. Nëpërmjet figurimit të fjalës *mermer* bëhen përshkri-

met më të fuqishëm, më mbresëlënës. *Mollëzat e lëmuara, sytë si mermer i plasaritur në formë rrezesh, gjithçka ishte si e trajtuar nga një skalitës që punonte për përjetësinë; nuk m'i hiqte sytë e tij të akullt, me plasaritjet e pamëshirshme prej mermeri në mes. Në motërzimin e dytë është përforcuar përdorimi i mermerit, duke shtuar, ishte një ftohje sipërane, me një lëmim mermeri të plasaritur te mollëzat dhe me një krisje te sytë. Ishte një krisje si prej qelqi. Mermeri është i plasaritur, kurse qelqi i krisur, kuptohet, prej trysnive dhe gërryerjeve të kohës që do të vijë dhe jo asaj që ka shkuar, pasi Poeti është ende i gjallë.*

Portreti i tij vizatohet, gjithashtu, me *kockë* dhe *lëkurë*, që është lënda e trupave të balsamosur, lënda e mumjeve të piramidave dhe mauzoleve. Fjalët *kockë* dhe *lëkurë* nuk përdoren shprehimisht, por përshkrimet e portretit i nënkuptojnë ato disa herë. *Mollëzat e lëmuara*, pra, prej kocke dhe lëkure, janë tipar dallues i mumjeve. Ndërsa në motërzimin e dytë të tregimit është shtuar: *ishte një krisje si prej qelqi, pas së cilës drita verbuese, e burgosur në kafkën e tij...* Ai nuk është më njeri me kokë, por një mumje me kafkë, domethënë me kocka. Në motërzimin e dytë, gjithashtu, është shtuar: *duhej ta ruaja ngrirjen e tij olimpikë prej squlljes së rëndomtë*. Mumja që ka vetëm *kockë* e *lëkurë* ngrin; trupi me muskuj, nerva etj., squllet.

Gjithçka te Lasgushi është mbuluar prej *ftohtësisë*. *Kishte po atë buzëqeshje të ftohtë si përherë, por me shumë dritë (ishte vallë afërsia e vdekjes që duke ia ftohur ia bënte megjithatë me të ndritshme gjithçka?). Dhe gjetkë Buzëqeshja e ftohtë mezi e ndiqte kokën në lëvizjen e saj; ai nuk m'i hiqte sytë e akullt...* Në motërzimin e dytë të tregimit dhe

akullsia është përforcuar. Mendimi i mësipërm është zhvilluar më tej: *Ai nuk m'i hiqte sytë e tij të akullt, me plasaritjet e pamëshirëshme midis, kërcënues dhe i pashmangshëm, si një ajsberg*. Poeti është **ajsberg**, prandaj, po në motërzimin e dytë, edhe dashuria, ndjenja më e zjarrtë, ka **ngrirë**. *Dashurimi... shfaqej në atë fytyrë nëpërmjet ftohtësisë. Ishte një ftohje sipërane*. Është **ftohtësia** e bustit, e mumjes së mauzoleve dhe të piramidave, është ftohtësia e akullit të përjetësisë, ftohtësia e portretit që ka ngrirë në kohë dhe që është jashtë botës njerëzore të ngrohtë. *Mermeri, kocka, lëkura, ftohtësia, akulli* përbëjnë lëndën gjuhësore të zgjedhur, me të cilën Kadare ka gdhendur bustin letrar të Lasgushit (1986) para se të gdhendte monumentin e tij në *Ftesë në studio* (1990). Busti e ruan përjetësisht shëmbëlltyrën e Poetit.

2. Shtërgu përmbi harrimin

Në totalitarizëm, në luftën e Poetit midis vdekjes dhe përjetësisë shtohet, duke ndërhyrë dhunshëm, harrimi zyrtar, i qëllimshëm, për ta mposhtur atë që në gjallje. Harrimi është paravdekja, është akti i parë i shkatërrimit të përjetësisë së tij. Harrimi ka dyzet vjet që i ka mbuluar famën, por ai e lufton me mbifuinë e tij. Gjendja fizike e Lasgushit është e ndërmjetme, midis qenies së gjallë dhe mosqenies. *Prej vitesh ishte dhe s'ishte*, ndërsa diku shkruhet se *kishte vdekur*. Më tepër se gjendja e tij fizike e njëmendtë, kjo është trajta e qenies së Poetit midis jetës-harrimit dhe përjetësisë, është mbijetesë në gjallje të tij, përballë harrimit zyrtar. Lasgushi

rishfaqet dy herë gjatë këtij harrimi. Një herë në mbledhjen e shkrimtarëve (motërzimi i dytë) dhe herën tjetër me bubullimën e dashurisë. Kështu, ai është i larguar (i harruar), por edhe i pranishëm. Rikthimi është pjesë e ciklit të qenies së tij, sikurse, për shembull, për zogjtë shtegtarë. Ky është cikli i njëmendtë i jetës dhe i lavdisë së Lasgushit, siç është edhe cikli që e nxjerr prej harrimit, është harku i mbijetesës. Rikthimi e shpërdjerr harrimin. Prandaj Poeti është shtërg.

Tregimi është shestuar me figurën e shtërgut, zogut shtegëtar — *madhështor me shpirt të gjorë*, të krijuar prej vetë Lasgushit (poezia *Mbarim vjeshte*). Përngjasimi i Poetit me krijimin e vet gjithmonë është një nga trajtat e përjetësisë së tij. Shtërgu që rikthehet fluturon mbi harrimin.

3. Mbipoeti përballë Tiranit

Në totalitarizëm, ku jeton Lasgushi, ka edhe një koordinatë të veçantë që përbëhet nga kundërshtia Tiran-Poet. Kjo kundërshti është ndryrë tepër ngushtësisht në përcaktimin *ata të dy*, por që është shpërndarë në tregim gjithandej.

Ata të dy (nënvizimi i autorit, në motërzimin e parë) *ndodheshin në të njëjtin qytetth: ai, munguesi i madh, gjysmë i harruar, gati-gati fantazmë dhe, tjetri, i gjithëgjendshmi, me portretet dhe citatet që gëlonin kudo të shkruara me bojë, me bar, me gurë, me trupa njerëzish gjatë manifestimeve sportive.*

Qëndrimi paradoksal — harrimi ndaj Poetit, i kundërqëndron lavdisë groteske të Tiranit.

Tirani dhe Poeti janë dy qeniet njerëzore më të

kundërta. Ato jo vetëm qëndrojnë ballëpërballë dhe në skajet më të fundit, por me një forcë shtytëse të jashtëzakonshme, janë gati të nxjerrin njëri-tjetrin nga orbita e jetës dhe e historisë. Ndërsa jeta dhe historia me ligjësitë e tyre i tërheqin ata të dy në brendësi, për të mos thënë, në qendër të tyre. Jeta, që ka lindur natyrshëm tiranët, po ashtu ka sjellë domosdoshmërisht poetët për barazpeshim, për të ndrequr, pikërisht, atë botë shpirtërore që tiranët me sjelljet e tyre e kanë zvetënuar, errësuar, shformuar apo shpërbërë. Prandaj antonimia Tiran-Poet të kujton shpeshherë marrëdhëniet ndërmjet diellit dhe hënës në sitemin diellor, ku dritëdhënës është vetëm dielli. Tiranët, në çdo kohë, kanë dashur të shndërrohen në diell, të paraqiten dhe të simbolizohen si të tillë nëpërmjet monumenteve, veprave arkitekturore, historike, kulturore etj. Për këtë kanë thirrur poetë, piktorë, skulptorë e muziktarë që, jo rrallë, i kanë simbolizuar me figura *diellore*. Me poetët ka ndodhur e kundërta. Edhe kur kanë qenë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të veprës së tyre, edhe kur kanë qenë tepër egotistë nuk kanë guxuar ta përngjasojnë veten me diellin. Por poetë të tjerë, adhurues kanë cilësuar diell vetëm njërin, më të ndritshmin mes tyre.

Në këtë realitet qenjësor (ekzistencial), sidoqoftë, Poeti ka më shumë arsye të shëmbëllehet me diellin, sepse është edhe *mbitokësor*, edhe *kozmiq*. Ai është i mbëshjellë me fantazinë krijuese, që sipas mendësisë mistifikuese, dukeq se merret vesh me zotat e qiellit ose me sistemet jashtëtokësore. Me frymëzimin e tij, të sendëzuar në kalin fluturues Pegaş, zbret në tokë dhe ngjitet në qiell dhe, anasjelltas, si kumtar midis banorëve të tokës dhe të qiellit. Vepra e tij vetëçliron

ngrohtësi ndjenjësore dhe dritë mendimi. Veçanërisht me pafundësinë rrezatuese të saj, poeti vetvetiu është një lloj dielli në botën njerëzore.

Nga gjithë ky përfytyrim për poetin, Lasgushi, në replikën e tij më të rëndësishme thotë:

— *Te Iliada e Homerit është një vend ku dielli zemërohet me Zeusin... Kështu, pra, dielli zemërohet me tiranin dhe e di si e kërcënon?* — Në Ferr do të zbres, do shndrit veç për të vdekurit (nënvizimi i autorit)..

— *Ja, pra, ç'kërcënim të hatashëm i bëri tiranit dielli... të tillë kërcënim të tmerrshëm dhe jo naze zonjushash duhet të bëjë poeti.*

Dielli është Poeti dhe jo Tirani. Prandaj botimi frëngjisht në *Le Monde* ka titullin *Kërcënimi i diellit*, që është dhe thelbi i tregimit. Është një simbol që e ngre Poetin në apoteozë.

Poeti është qendra e jetës, përballë Tiranit që është qendra e pushtetit, e fuqisë, nënshtrimit dhe së keqes. Tirani është i gjithëpushtetshëm. Poeti është i gjithëfuqishëm, dy herë sipëran: krijues dhe i dashuruar. Ai është misionar çudibërës në botën e rrezikuar. Me një gjest dashuror, të hutuar, të përgjumur gjallëron krejt mjedisin, e shkëput nga vorbulla e pushtetit tiranik dhe e tërheq qark botës së vet magjepsëse. Poeti është demiurgu shpirtëror i kombit — *kombin e bëjnë poetët*, përkundër Tiranit, që nënkupton zhbërjen e kombit.

Lasgushi, në këtë mënyrë, nuk është vetëm *mishërim i Poetit*, krijues i vlerave shpirtërore, por edhe simbol i *Poetit misionar*, rregullator i jetës, simbol i *Poetit Mesi* — çlirues e shpëtimtar si me fjalën — veprën ashtu dhe me bëmat e tij.

Dhe unë do të kisha qenë gati t'i bija në gjunjë,

duke iu lutur në emër të të gjithëve që të mos e linte pa e përmbushur atë mision. Mjeshtër, kalorës i përjetshëm, bëjeni, për ne të gjithë, për...e nsë *dashunës botës sanë*, thotë heroi rrëfyes, i ekzaltuar dhe i përgjunjur gjatë gjithë tregimit si besimtari para altarit. Përdorimi i shprehjes së famshme të Buzukut në *Meshari e nsë dashunës botës sanë*, me të cilin fillon letërsia shqipe, e për afron Lasgushin me atin e librit shqip, për të nënvizuar fuqinë e madhe ndikuese të tij. Me tërë këto dhunti, ky nuk është thjesht Poeti, por është *Mbipoeti*. Krijuesi i vlerave shpirtërore — Poeti, vetvetiu është i sublimuar, ndërsa Kadare e tejsublimon dhe e mbisublimon, duke krijuar *kultin* dhe *mitin e Poetit* ose *Mbipoetin*, madje në të sublimohet dhe një lloj *uni narcizik*, karakteristikë e përhershme e poetëve të mëdhenj, sikurse ka qenë edhe për Llazar Gushon. *Uni narcizik* i tij, i shfaqur në mbivlerësimin, mistifikimin teatralizues të vetes, në kontekstin e tregimit, është argument psikologjik i epërsisë mbi Tiranin, është trajtë e sublimimit të Poetit.

Figura madhështore e *Mbipoetit* është epërsia e sigurt përmbi Tiranin. Mbinjeriu, por edhe *Mbipoeti* krijohet nga një shpresë ideale e fuqishme, që nëpërmjet mendimit mund të ndryshojë botën, gati të pandryshueshme. Është ndofta, ky, shkak i brendshëm i Ismail Kadaresë që ka krijuar, në rrethanat e totalitarizmit të pandryshueshëm, figurën e *Mbipoetit*, që mundte ta zbuste, sadopak, ngrirjen e tij prej akullnaje. *Mbipoeti* mund të ishte kundërshtari i vetëm i madhërishëm i Tiranit dhe shpëtimtari i vetëm i madhërishëm i botës në totalitarizëm. Prandaj, *Ikja e shtërgut*, që është një tregim realisto-simbolik, është dhe një apoteozë për

Poetin, për energjitë e tij të jashtëzakonshme, për
dhuntitë sipërane, për kënaqësitë që iu blaton të
tjerëve.

BASHKIM KUÇUKU

VEPRA TË ISMAIL KADARESE NË GJUHËN SHQIPE

FRYMËZIME DJALOSHARE (1954)
ËNDËRRIMET (1957)
SHEKULLI IM (1961)
PËRSE MENDOHEN KËTO MALE (1964)
GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR (1963)
QYTETI I JUGUT (1967)
MOTIVE ME DIELL (1968)
DASMA (1968)
KËSHTJELLA (1970)
KRONIKË NË GUR (1970)
LINJA TË LARGËTA (1971)
AUTOBIOGRAFIA E POPËLLIT NË VARGJE (1971)
NËNTORI I NJË KRYEQYTETI (1975)
DIMRI I VETMISË SË MADHE (1973)
KOHA (1976)
DIMRI I MADH (1977)
EMBLEMA E DIKURSHME (1977)
URA ME TRI HARQE (1978)
GJAKFTOHTËSIA (1980)
PRILLI I THYER (1980)
KOHA E SHKRIMEVE (1986)

"Mëqada e gjyqeve"
"Zhelja e ditë" V. Saniç

- KONCERT NË FUND TË DIMRIT (1988)
- DOSJA H. (1990)
- FTE SË NË STUDIO (1990)
- ESKILI - KY HUMBËS I MADH (1990)
- ARDHJA E MIGJENIT NË LETËRSINË SHQIPE (1991)
- ËNDËRR MASHTRUESE (1991)
- PËRBINDËSHI (1991)
- PESHA E KRYQIT (1991)
- NGA NJË DHJETOR NË TJETRIN (1991)
- PIRAMIDA (1995)
- SHKABA (1996)
- LEGJENDA E LEGJENDAVE (1996)
- DIALOG ME ALAIN BOSQUET (1996)
- SPIRITUS (1996)
- KUSHERIRI I ENGJEJVE (1997)
- TRI KËNGË ZIE PËR KOSOVËN (1998)
- KOMBI SHQIPTAR NË PRAG TË MIJËVJEÇARIT TË TRETË (1998)
- PALLATI I ËNDRRAVE (1999)
- IKJA E SHTËRGUT (1999)

1 Engjëjt qajonë

Dëborade të Damir Xhepit
E. Hemujçaj

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	5
Përkryerja artistike e një vepre bën pjesë në lirinë e saj, <i>bisedë e ISMAIL KADARESE</i> <i>me studiuesin BASHKIM KUÇUKU</i>	7
Ikja e shtërgut, <i>varianti i vitit 1986</i> ,	13
Ikja e shtërgut, <i>varianti i vitit 1998</i> ,.....	33
Apoteoza për poetin ose kundërtirania, <i>studim nga BASHKIM KUÇUKU</i> ,	67
Vepra kryesore të ISMAIL KADARESE në gjuhën shqipe,.....	95
Përmbajtja.....	97